




i (a.s.)
**ISHTE MË
I MIRI I NJERËZIMIT**



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

REDAKTOR
Andrin Rasha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 10 (473)
Tetor, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- | | |
|---|--|
| 4 | Ai u dërgua për të përsosur moralet fisnike / Mehmet Disha |
| 6 | Lindja e Profetit Muhamed (a.s.), pikë kyçe në historinë e njerëzimit / Dorian Demetja |
| 8 | Lajme / Aktivitete |



- | | |
|----|--|
| 12 | I Dërguari i Zotit, Muhamedi (a.s.) / Alija Izetbegović |
| 16 | Zemra jote, si toka e përhumbur / Ali Asakir |
| 18 | Karakteristikat e të Dërguarit të Allahut (a.s.) / Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1", botim i KVMH |
| 20 | Bazat e fitimit të dijes së shariatit dhe fikhu i da'ues / Prof. Doc. Shahid El'bushuhi |
| 22 | Gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme e Kur'anit / Said Nursi |
| 24 | Mevludi si manifestim fetar / Ismail Ahmed |



- | | |
|----|--|
| 28 | Mbi punën / Retrospektivë |
| 32 | Hasan Selami (1910-1943) / Personalitet |
| 34 | Edukimi fillon në familje / Aisa Kokiçi |
| 36 | Mekanizmat mbrojtës në enët e gjakut / Murat Yasar |
| 38 | Boshllëku / Xhynejdi Suvavi |



Ai (a.s.)
**U DËRGUA PËR TË
PËRSOSUR MORALET FISNIKE**



Të flasësh për të Dërguarin e Zotit, Muhamedin a.s., do të thotë të marrësh në konsideratë jetën e një burri, i cili u dallua për karakteristika të veçanta e të papërsëritshme, që u shfaqën tek ai qysh në moshë të njomë dhe me kalimin e viteve do të bëheshin veti të përsosura, nga të cilat u emetuan dhe do të emetohen rrezatimet më humane për të gjithë brezat. Në lidhje me moralin e Muhamedit a.s., Allahu në Librin e Tij thotë: "Vërtet, ti je në shkallën më të lartë të moralit", ndërsa vetë i Dërguari i Allahut ka thënë: "Jam dërguar për të plotësuar moralet më të nderuara" dhe "Mua më ka edukuar Zoti im me edukatën më të bukur".

Fraza 'moralet më të nderuara' është e shkurtër, por që në personalitetin e Muhamedit a.s. përfshin kuptime të thella; përfshin dëshirën e tij për të mirën e për të vërtetshmen dhe veprimin sipas këtyre parimeve; përfshin trajtimin e të tjerëve me dashuri e butësi; përfshin mbajtjen e lidhjeve me njerëzit e gjakut, bamirësinë ndaj fqinjit, etj.

Moralet më të përsosura të Muhamedit a.s. përfshijnë takimin e të tjerëve me fytyrë të qeshur, largimin e zemërimit, shoqëruar me ndjenjën e turpit. Ai përshëndeste ata që i njihje e ata që nuk i njihje me fjalën e bukur e të ëmbël 'Selam - Paqe', pa lënë mënjanë bujarinë për t'u ardhur në ndihmë të tjerëve me çfarëdo që t'i ndodhej. Njëkohësisht, vetitë më të plotësuarat te ky Profet, përfshijnë frenimin e zemërimit e të prepotencës, ashtu siç përfshijnë faljen ndaj atij që i bënte keq dhe përgjigjen me të mirë ndaj vetë të keqes; përfshijnë pastrimin e plotë të zemrës nga urrejtja, qëndrimin larg nga veprimet e kohës së injorancës përpara Islamit, heqjen dorë nga veprimi sipas dëshirës dhe nga diskutimet e kota.

Ai jo vetëm që përgëzonte për të mirë, por vazhdimisht i lutej Allahut që e mira të mbizotëronte kudo e kurdo. Pejgamberi asnjëherë nuk u shkaktoi dëme të tjerëve as me fjalë, as me vepër dhe as me gjykimin e tij.

Muhamedi a.s. ndiente dhimbje për dhimbjet e njerëzve dhe gëzohej për gëzimet e tyre. Në derën e tij trokisnin të gjithë, të huajt që kishin nevojë për përkrahje materiale e morale dhe ata që, për një arsye apo një tjetër, kalonin nëpër situata të vështira. Të gjithë gjenin te Muhamedi mbështetjen e duhur dhe ai qëndronte përkrah tyre, jo për t'iu imponuar, por vetëm për t'i ndihmuar dhe për të mos lënë që vështirësia që kalonin t'i tërhiqte në rrugën e gabuar.

Për sa i përket 'edukimit me shembull praktik', profeti Muhamed a.s. është modeli më i përkryer në të gjitha veprimet që njeriu mund të kryejë gjatë jetës. Tek ai mishërohej fjala me veprimin. Ai asnjëherë nuk e la pas dore higjienën personale,

asnjëherë nuk hëngri sa të ndiente rëndim në stomak. Porositë e këshillat e tij për shëndetin përbëjnë një kapitull më vete, prandaj dijetarët myslimanë i kanë sistemuar në libra të veçantë.

Me të tilla veti e pajisi Allahu Profetin e Tij, sepse ai do të ftonte në të vërtetën, për atë të vërtetë për të cilën Allahu na ka krijuar, për të adhuruar vetëm të madhin Zot. Morali i tij i bukur dhe i plotësuar linte gjurmë në thirrjen që ai u bënte njerëzve për të lënë udhën e gabuar të idhujtarisë dhe për të besuar e adhuruar vetëm Allahun, Zotin Një e të Vetëm.

Me të tilla cilësi të bukura e pajisi Allahu të Dërguarin e Tij fisnik, kur thotë: "Ti ishe i butë ndaj tyre ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërgur, ata do të largoheshin prej teje, andaj tregohu zemërgjerë ndaj tyre, kërko për ata që t'u falen mëkatet dhe këshillohu me ata për të gjitha çështjet (për punët e kësaj bote) dhe, kur të vendosësh, mbështetu vetëm në Allahun; me të vërtetë Allahu i do ata që kërkojnë mbështetjen e Tij."

Allahu e pajisi Muhamedin a.s. me vetinë e fjalës, sepse me thirrjen që do të bënte për të vërtetën e për t'u udhëzuar në rrugën e drejtë, ai detyrimisht do të përballonte reagimet e kundërshtimet më të ashpra. Prandaj Allahu, përpara se ta ngarkonte me misionin profetik, i dhuroi një moral të tillë që pajtonte zemrat, që qëndronte më lart se dëshirat dhe, në sajë të tij, Muhamedi a.s. dëshmonte vetëm të drejtën, kishte dashuri për njerëzit e tij, i afrohej mikut dhe nuk shfaqte armiqësi ndaj askujt. Ai ishte shembulli i modestisë dhe i pastërtisë shpirtërore e fizike në mesin e njerëzve që e rrethonin, qoftë në fjalë, në vepër e në mendime.

Profeti a.s. kurrë nuk iu nënshtrua dëshirave e hamendjeve, ai ishte i drejtë e besnik, i ndihmonte të gjithë, sidomos të pafuqishmit e nevojtarët. Ai e falte këdo që i bënte atij padrejtësi, por nuk toleronte kurrsesi shkeljen e urdhrave të fesë së Allahut, ose të nëpërkëmbej nderi i dikujt. Për të tilla çështje Profeti ishte i paepur dhe tepër i qartë në mbrojtjen e ligjit të fesë e të vlerave morale.

Në çdo pikëpamje të jetës, ai ishte vetëm pozitiv, sepse morali i tij nuk mund të pajtohej me negativin. Gjithmonë kërkonte të mirën, bënte vetëm të mirën dhe qëndronte larg së keqes. Edhe në punët personale e të sjelljes së tij në familje, Profeti mbetet modeli i kryefamiljarit të kujdesshëm dhe i bashkëshortit ideal. Edhe në punët e tregtisë që ushtronte dhe me të cilën siguronte mjetet e jetesës, Muhamedi a.s. ishte tepër i ndershëm, tolerant dhe shumë i durueshëm.

Të gjitha këto morale të bukura u shtrinë në gjërësi e në thellësi akoma më shumë pasi u ngarkua me misionin profetik.

LINDJA E
Profetit Muhamed a.s.
PIKË KYÇE NË HISTORINË E NJERËZIMIT

Për këtë vit, tetori i datës 7 shënoi lindjen e bekuar, lindjen e vulës së profetëve, Hz. Muhamed (a.s.). Të gjithë kombet e popujt e ndryshëm, sipas rastit e vendit, festojnë ditëlindjen e njerëzve të tyre të shquar, të dalluar për vepra trimërie, bamirësie, letrare, filozofike e shkencore, duke i shërbyer jo vetëm kombeve përkatëse, por edhe mbarë njerëzimit. Këta njerëz të mëdhenj, jo vetëm i kanë sjellë dobi e përfitim popujve të ndryshëm, por bëhen më vonë shembuj për brezat e ardhshëm që të pasojnë gjurmët e tyre. Por, nëse ekziston një ngjarje, e cila mund të shkaktojë me të vërtetë gëzim dhe pjesëmarrje të përbotshme, ajo, padyshim, është lindja e Profetit të bekuar, Muhamed Mustafasë (a.s.). Ai i solli mbarë botës mesazhin e paqes dhe harmonisë në atë kohë, kur ajo kishte nevojën më të madhe për të.

Hz. Muhamedi a.s. erdhi në këtë jetë ditën e hënë, më datë 12 të muajit Rebiul-evvel, të vitit 571. Ditëlindja e të Dërguarit të Allahut, profetit të Islamit, është ngjarja më e rëndësishme në të gjithë historinë e njerëzimit, sepse nëpërmjet këtij burri, i madhi Zot do të derdhte mëshirën e Tij mbi të gjitha botët, do të ndriçonte mendjet e nxira nga padija e politeizmit, do të lartësonte dhe do të vinte personalitetin e njeriut në vendin që i takon. Kjo lindje është një favor i Allahut për të gjithë njerëzimin. Zoti ynë i Lartë urdhëron kështu në Kur'an: "Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar." [1]

Shikoni bujarinë, ndihmën dhe favorin e Allahut, që u dërgon njerëzve për profet njërin nga mesi i tyre, nga origjina e tyre, i cili ndan me ta të njëjtat ndjenja e mendime, i cili është udhëzues e prijës i tyre në rrugën që shkon te e Vërteta, i cili mund të dalë në krye të tyre nëse është nevoja për imam, i cili mund të hipë në minber nëse është nevoja për hatib, i cili mund të vejë vulën e të presë monedha nëse është nevoja për një drejtues shteti, i cili mund t'i komandojë ata në mënyrën më të përkryer nëse është nevoja për t'i komanduar...

Profeti Muhamed a.s. është profeti i fundit që Allahu i dërgoi njerëzimit. Ai është njeriu më i lartë, më me vlerë dhe më i respektuari nga të gjitha krijesat e tjera. Ai është profeti i mëshirës dhe i dashurisë. Allahu e dërgoi atë si mëshirë për mëkatarët e të devotshmit, për burrat e gratë, për fëmijët e të moshuarit, për besimtarët e mohuesit, për njerëzit e xhindet. Madje, Allahu praninë dhe ekzistencën e Muhamedit a.s. në tokë, e bëri garanci dhe siguri për të gjitha krijesat, kur thotë: "Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët." [2]

Profeti i fundit është krijesa më e dashur tek Allahu (xh.sh.) dhe, duke qenë i tillë, ashtu duhet të jetë edhe për ne që pretendojmë se ndjekim rrugën e tij. Dashuria për profetin a.s. është njëkohësisht dhe dashuri për bukurinë e fisnikërinë e karakterit të tij, për drejtësinë, modestinë dhe forcën e brendshme të njeriut, të cilat profeti i zotëroi në shkallën më të lartë. Myslimanët obligohen që dashurinë ndaj tij ta vendosin mbi dashurinë ndaj çdo krijese tjetër, përfshi këtu veten dhe të dashurit e tyre. Për këtë, në hadithin e transmetuar nga Enesi (r.a.), Profeti (a.s.) ka thënë: "Askush prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë, derisa të bëhem për ju më i dashur se prindërit tuaj, fëmijët tuaj dhe të gjithë njerëzit e tjerë." [3]

Profeti ishte njeriu i paqes e i qetësisë. Ne e dimë dhe e besojmë kategorikisht se mesazhi që ai përcolli, gjithashtu ishte një burim paqeje e qetësie dhe historia është dëshmitarja më e madhe për këtë. Ja pra, e vetmja zgjidhje për ta bërë njerëzimin që ta shijojë përsëri këtë paqe e qetësi, është që t'ua bëjmë të njohur njerëzve Profetin dhe mesazhet që solli ai. Sepse, në raport me sa do të njihet ai dhe në sajë të asaj dashurie, do të ndërrojë gjendja e shoqërisë. Kështu, njerëzimi do të shpëtojë së bredhuri pa drejtim e së qeni lodër në duart e kohës, do të shpëtojë nga mjerimi i ndëshkimit në të dy botët dhe do të ngjitet në qiellin e të qenit njeri.

Duke përkujtuar ditëlindjen e tij, nuk bëjmë gjë tjetër veçse i bëjmë thirrje vetes, që të njihemi sa më mirë me jetën e Profetit tonë. Duke njohur figurën e pastër dhe të bekuar të Hz. Muhamedit (a.s.) dhe duke i vënë vetes detyrë të zbatojmë urdhrin e Allahut (xh.sh.) për të pasur atë model në jetën tonë, do të bëhemi më njerëzorë dhe, me lejen e Allahut, do të jemi mysli-manë të vërtetë, që do të thotë njerëz të bindur me vetëdije për ta kaluar jetën e kësaj bote në përputhje me urdhrat e Kur'anit dhe porosinë e të Dërguarit të Allahut.

Jetesa e Profetit (a.s.) nga njëra anë na nxit të lakmojmë arritjen e përsosmërisë dhe nga ana tjetër na ndihmon të pranojmë paaftësinë tonë për të qenë të pagabueshëm duke na shtyrë të jetojmë në paqe me veten si robër të penduar të Zotit, me shpresë në mëshirën e madhe të Tij. Që besimi ynë të jetë i shëndoshë dhe i plotësuar, duhet ta duam Profetin tonë duke ndjekur rrugën e tij dhe duke u lutur për të sipas urdhrit kuranor: "Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me selam" [4].

[1]. Al 'Imran, 164.

[2]. Enbija, 107.

[3]. Buhariu-Muslimi.

[4]. Ahzab, 56.



1

ÇELET ZYRTARISHT VITI I RI SHKOLLOR 2022-2023

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ishte i pranishëm në ceremoninë e çeljes në Medresenë e Tiranës, ku përpos tij në këtë ceremoni ishin të pranishëm Drejtori i Medresesë, z. Ndiçim Gjimi, stafi pedagogjik i këtij institucioni arsimor, familjarë dhe nxënësit e ciklit fillor dhe atij të mesëm.

Kryetari Spahiu, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, parashtroi rëndësinë e medresesë si një institucion i veçantë arsimor, duke qenë se i formon brezat e rinj jo vetëm me dije shkencore por i pajis ata edhe me besimin në Krijuesin e Gjithësisë.

“Medreseja është një vend i çmuar, i mirëpret fëmijët, i stimulon ata, i shoqëron në proceset e rritjes personale, kulturore dhe profesionale, e mbi të gjitha i pajis me dije e moralin më të bukur.” – tha z. Spahiu

2

TAKIM ZYRTAR ME NJË DELEGACION SHTETËROR NGA INDONEZIA

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, priti në një takim zyrtar një delegacion shtetëror nga Indonezia.

Delegacioni kryesohej nga Zëvendës Kryetari i Asamblesë Konsultative të Republikës së Indonezisë, Dr. H. Muhammad Hidayat Nur Wahid, së bashku me, Sh.T.Z. Iwan Bogananta, Ambasadori i Indonezisë dhe, z. Sukamta Mantamiharja, z. Johan Rosihan, z. Abdul Hakim, Anëtarë të Asamblesë Konsultative të Republikës së Indonezisë si dhe znj. Yeti Oktaviani, staf.

Kryetari Spahiu e cilësoi këtë vizitë si një etapë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve, jo vetëm në aspektin e shkëmbimeve parlamentare, në kuadër të së cilës delegacioni vizitoi Shqipërinë, por edhe në ngritjen e forcimit të bashkëpunimit edhe me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Kryesuesi i delegacionit dhe anëtarët që e shoqëronin vlerësuan rolin e rëndësishëm që luan Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në përcimin e mesazhit fetar te besimtarët, dhe veçuan lart harmoninë e dialogun ndër fetar në vendin tonë.

Ata shprehën interesin e tyre mbi potencialet që ofron KMSH në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit mes Indonezisë dhe Shqipërisë.





3

KRYETARI I KMSH MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE NË EGJIPT





4

IMAMI I QABES VIZITON SHQIPËRINË

Imami i Qabes, Hirësia e Tij, dr. Abdullah Avad el-Xhuheni zhvilloi një vizitë katër ditore në Shqipëri, me ftesë të kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Imami i Qabes bashkë me delegacionin e tij e nisi vizitën me një takim zyrtar në selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku janë pritur nga kryetari i KMSH-së, dhe bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë vizitës në vendin tonë imami mori pjesë në ceremoninë e çertifikimit të studentëve të parë të Institutit të Studimeve Islame të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, vizitoi Kolegjin Universitar Bedër, Medresenë e Tiranës, dhe mori pjesë me ligjërata, lexim Kurani dhe priu në namaz në disa nga xhamitë kryesore të Myftinisë së Tiranës, Elbasanit, Korçës, Shkodrës dhe Kavajës.

Kjo është e hera dytë që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë fton në vendin tonë një imam të Qabes.





I DËRGUARI I ZOTIT *Muhamedi a.s*



Është rasti që të kujtojmë disa ngjarje nga jeta e frytshme e Profetit të Islamit, Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., me rastin e ditës së lindjes së tij, e me këtë, para së gjithash, siç thotë Kur'ani, kemi shembullin më të mirë dhe shëmbëlltyrën për jetën tonë personale. Ashtu si qindra myslimanë në tërë botën, ne e kujtojmë atë. Këtë e bëjmë nga dashuria, jo nga adhurimi për të, sepse ne myslimanët vetëm Zotin adhurojmë.

Pejgamberi ynë u lind në një familje fisnike, por të varfër, në familjen Hashimi, e cila i përkiste fisit Kurejsh. Të paktë janë ata myslimanë që s'kanë dëgjuar tregime të prekshme për vdekjen e hershme të nënë Amines, gruan e fisme e të mirë, për jetën e Muhamedit a.s. të ri si jetim, për dashurinë e gjyshit, Abdul-Mutalibit e më pas të xhaxhait Ebu Talibit, nën mbrojtjen e të cilit ai u rrit. Disa hollësi dhe tregime nga këto vepra për jetën e Muhamedit a.s., kur i dëgjonim si fëmijë, na ndillnin lotët në sy dhe për shumë prej nesh, këto tregime kanë mbetur si kujtimet më mbresëlënëse të fëmijërisë sonë.

Mbi këtë bazë nga fëmijëria jonë u shtuan më vonë histori të tjera dhe këto kanë bërë që secili prej nesh me fantazinë e vet të formojë fizionominë e Profetit të Zotit sikur e sheh dhe e mendon. E shohim në pozicione të ndryshme: si gazmor dhe fatlum burrin e h. Hadixhes, eremit të kredhur në mendime në malin Hira, tregtarin e dëgjuar (e njohur) që udhëheq karvanët deri në Sirinë e largët, luftëtarin e guximshëm në luftën e Uhudit, diplomatin specialist (e shkathët) në marrëveshjen e Hudejbijes, njeriun e zakonshëm që vajton mbi varrin e mikut të vdekur dhe mbi të gjitha këto, besimtarin e fortë dhe vizionarin që dërgon mesazhe në të katër anët e botës së atëhershme, sepse beson në mënyrë të patundur për rëndësinë e misionit të vet në botë.

Të gjitha këto cilësi, aftësi e forca të cilat zakonisht përjashtojnë njëra-tjetrën, janë sintetizuar te një personalitet, personaliteti i Profetit të Zotit, Muhamedit a.s.

Në qoftë se Islami është harmonia e forcave kundërshtarë, të atyre nga trupi dhe të atyre nga shpirti, atëherë Muhamedi a.s. është personifikimi i kësaj shkence që solli ai dhe ia shpalli botës. Kur Kur'ani deklaron se Muhamedi a.s. është vetëm njeri dhe vë në dukje këtë anë njerëzore të karakterit të tij, ai nuk e ul Profetin, por lartëson njeriun. Sepse, sipas Kur'anit, ai nuk është as hyjni, as engjëll, por në të vërtetë është njeriu në formën më të përsosur nga krijesat e Zotit. Muhamedi a.s. ka qenë njeriu më i madh që ka ekzistuar ndonjëherë.

Muhamedi a.s. ka qenë i bukur, por jo bukurosh. Ka qenë i mirë, por jo tatëlosh (baballëk, naiv). Ka qenë trim, por jo i ashpër. Ka qenë i zgjuar, por jo filozof. Ka qenë misionar, por jo ëndërrimtar. Ka qenë këmbëngulës, por jo kokëfortë. Ka qenë i mençur, por jo dinak. Të tëra këto sintetizoheshin në personin e tij në masën e duhur, dhe, në këtë njerëzillëk suprem, ndodhej sekreti i forcës së Muhamedit a.s. me të cilën bëri për vete mjedisin (rrethinat, vendin).

Një shkrimtar perëndimor duke polemizuar me

gjithfarë shpifësish të librave kundër Muhamedit a.s. – dhe libra të tillë kishte shumë – shkruan: "Diçka nga kreshniku i vërtetë kishte ky njeri, madje këta arabë të egër duke luftuar e duke bërë presion ndaj tij për 23 vjet dhe vazhdimisht duke e ngacmuar, nuk do ta respektonin kështu... Asnjë lloj mbreti dhe pushteti nuk është respektuar kështu si ky njeri që ishte veshur me një mantel të cilin e arnonte vetë dhe kjo për 23 vjet rresht përballë një prove të ashpër e brutale".

Asgjë nga ajo që i ka ndodhur Muhamedit a.s. gjatë shpalljes së jashtëzakonshme nuk ishte e mbinatyrshme as mbinjerëzore, dhe s'duhet të ishte e tillë. Sepse ai erdhi për njerëzit, të tillë siç janë këtu në tokë. Ai, ashtu si ne, e përjetonte frikën, dhimbjen, dashurinë.

Drama në Uhud, kur ushtria myslimane thuajse u shkatërrua dhe Profeti i Zotit u plagos, na tregon se Zoti nuk i ndryshon ligjet e Tij dhe këto zakone vlejné njëlloj për myslimanët, që ata të luftojnë e të punojnë me mençuri në qoftë se duan të fitojnë.

Allahu asgjë nuk ka përgatitur posaçërisht për ta, që të fitonin pa punë e pa luftë. Kjo nuk është vetëm porosia dhe konkluzioni i Uhudit, kjo është porosia e tërë Islamit dhe e jetës së Profetit të Zotit. Jeta e Muhamedit a.s. ka qenë më se njerëzore dhe njerëzore në kuptimin më të mirë të kësaj fjale.

Kur u rrit dhe mund të punonte, ai menjëherë filloi të kërkonte një punë të dobishme. Para s'kishte dhe gjyshi nuk mund ta ndihmonte. Prandaj vendosi që të merrte devetë dhe delet e xhaxhait për t'i kullotur dhe u vu në dispozicion të disa fqinjëve që t'u ruante kopetë. Kjo provokoi thashethemet, shpifjet. Disa kushërinj më të pasur iu kundërvunë kësaj pune se kjo ua cenonte famën, sepse ruajtja e kopeve të huaja ishte punë e robërve dhe e vajzave të varfra. Por Muhamedi a.s. nuk u dorëzua. Filloi ta bëjë këtë punë me dëshirë, sepse ajo i kujtonte fëmijërinë dhe e afronte me natyrën, ku me dëshirë mund të mendonte e meditonte. Këtë detaj nga jeta e Muhamedit a.s. e përmendim, sepse kjo gjë me intuitë na flet qartë për një pamje të karakterit të tij. Pra, ai ka qenë plotësisht i çliruar nga mendjemadhësia dhe mburrja. E donte të vërtetën dhe thelbin e gjërave. I tillë mbeti deri në vdekje. Kur u plak dhe u bë ngadhënjyesi i pakundërshtueshëm i popullit të vet dhe udhëheqës i tërë Arabisë, mbeti i tillë si ai bariu i varfër që kulloste kopenë në fushat e Mekës. Edhe atëherë shtëpia e tij ishte më e thjeshta dhe ushqimi i tij më i shpeshtë ishte buka e elbit dhe një grusht hurma. Ai me duart e veta arnonte mantelin (xhyben) dhe veshjet e tjera dhe njëkohësisht kryente dhe punët e shtetit. Kur i mëson tërë këto gjëra, a ke se si të mos e duash këtë njeri?

Muhamedi a.s. e ka pasur si rregull që çdo vit në muajin e Ramazanit të tërhiqej (mënjanohej) në vetmi dhe qetësi dhe këtë muaj ta kalonte duke u lutur e medituar për çështje kardinale të cilat në tërë kohërat i preokuponin shpirtat e njerëzve të vërtetë: Ç'jam unë? Ç'është ky mjedis i pafund që njerëzit e quajnë rruzullim (gjithësi)? Ç'është jeta? Përse vdesim? Ç'duhet të besojmë? Ç'duhet të bëj? As muret e trasha e trasha të kodrës Hira, as shkretëtira e errët ranore nuk i përgjigjeshin. As qielli i madh me yjet e

vet të shndritshëm, nuk i përgjigjej. Asnjë lloj përgjigje nuk mori. Vetëm pushteti shpirtëror i këtij njeriu dhe frymëzimi hyjnor mund t'i përgjigjeshin këtyre pyetjeve. Kështu e përshkruan gjendjen e shpirtit të Muhamedit para shpalljes, një shkruar, një respektues i madh i Profetit tonë.

Siç e dimë përgjigjet për këto pyetje i mori Muhamedi a.s. një mbrëmje në muajin e Ramazanit, kur drama e tij e brendshme ishte në kulmet e saj. "Ikre, bismi Rabbike." Zoti e mëshiroftë, shpirtin e tij e ndriçoi drita dhe ai për një moment mësoi të gjitha ato që shpirti i tij kishte kërkuar kaq gjatë.

Shpallja që nga kjo botë zgjati për 23 vjet të jetës së tij, por ajo më e rëndësishmja, ajo kryesorja u zgjidh vetëm për një moment në malin Hira, e kjo është se njeriu nuk është vetëm, që Zoti ekziston e sundon tërë botën. Çdo gjë erdhi pas kësaj kohe ishte vetëm zhvillimi i kësaj baze të vërtete që ishte më e rëndësishme, sepse i përkiste marrëdhënies ndërmjet Zotit dhe njeriut, por edhe një e vërtetë që përcaktonte edhe lidhjen (marrëdhënien) e re të njeriut me njeriun. Muhamedi asokohe ishte 40 vjeç.

Dihet që Muhamedi, pas kësaj shpalljeje të parë, në dilemë dhe i shqetësuar pa kufi, shkoi te shoqja e vet besnike, i besoi të fshehtë (sekretin) e ajo e inkurajoi, e forcoi dhe u bë ajo e para që e pranoi – u bë myslimania e parë. Përveç këtyre që pjesa femërore e tërësisë sonë nga kjo ngjarje mund të nxirrte konkluzione shumë të rëndësishme për vete, këtu ekziston dhe një detaj që ndriçon një anë të profetit të Zotit si njeri.

Pra, shumë vite më vonë, kur e mira Hatixhe, kishte ndërruar jetë, gruaja e re dhe e bukur e Muhamedit, Aishja, paksa xheloze për kujtimet e bukura që përmendte (ushqente) Muhamedi ndaj gruas së parë, iu kthye me fjalët: "E pse, a s'jam unë më e mirë se Hatixheja; ajo ishte vejushë, e vjetër, dhe e ka pas humbur hijeshinë e vet. Më do më tepër mua apo atë?" "Jo, për Zotin e vërtetë, – u përgjigj Muhamedi a.s. – Ajo më besoi kur s'më besoi njeri. Në tërë botën unë asokohe kisha vetëm një mik, e ky ishte ajo". Pasardhësit e falënderojnë këtë grua të madhe e me plot të drejtë e kanë cilësuar me emrin "Umul musliminë" – nëna e tërë myslimanëve. Kur Muhamedi a.s. u bë i ndërgjegjshëm për misionin që iu revelua, nuk pati asnjë pengesë e as forcë që ta ndalonte. Feja e re, me tërë ngarkesën e saj, donte të thoshte përmbysje e përgjithshme, jo vetëm në besim, në kulte e rregulla, por edhe në marrëdhëniet familjare e shoqërore. Për këtë shkak u egërsua rezistenca e aristokracisë fisnore, e cila sundonte pa arsye shpirtat dhe trupat e nënshtetasve të vet dhe që këtu filloi lufta për jetë e vdekje ndërmjet kultit të rremë të idhujve dhe besimit në një Zot të vetëm e të Gjithëpushtetshëm. Thuhet se në një rast, xhaxhai i mirë Ebu Talibi, duke pasur frikë për jetën e Muhamedit, e thirri dhe i propozoi: Të heshte për gjithçka, të besojë te vetvetja, të mos i zemërojë të fuqishmit e Mekës, sepse me këtë vë në rrezik veten dhe fisin e tij, i cili sipas rregullave të atëhershme ishte i detyruar ta mbronte (Muhamedin). Muhamedi u përgjigj: "Sikur të më vendosnit Diellin në

anën e djathtë dhe Hënën nga e majta, unë nuk do të hiqja dorë nga misioni im."

Këto fjalë vendimtare e hutuan Ebu Talibin. Ai nuk pushoi së mbrojturi Muhamedin a.s., por nuk mundi ta kuptonte. Nuk mundi ta kuptonte se nuk besoi. Sikur të besonte, do të kuptonte se ekzistojnë çështje, vlera e të cilave nuk lejon të krahasohen dhe që rëndojnë më tepër se të gjitha llogaritë, interesat, shkaqet, madje edhe të jetës e të vdekjes. Ekziston Zoti e ne jemi krijesat e Tij, kjo është një e vërtetë elementare, e vërtetë e prekshme, një e vërtetë më e parë dhe më e fundit se të tjerat, ndaj së cilës arsyet e konsideratat e tjera janë të pafuqishme. Në këtë takim të Ebu Talibit dhe Muhamedit a.s. ka një simbolikë të thellë. Ebu Talibi ka qenë një njeri i mirë dhe i komunikueshëm. Edhe Muhamedi i tillë ishte, por para së gjithash ishte besimtar. Për këtë arsye, Ebu Talibi i përshtatet rregullit të sendeve, ndërsa Muhamedi a.s. mbeti i papërkulur dhe dalëngadalë e ndryshon këtë rregull të kaluar.

Ithtarët e kësaj feje, Muhamedi a.s. dhe bashkësia e vogël unike e besimtarëve që e ndiqte atë, i përballojnë, për këtë arsye të gjitha provat me të cilat u përballën. E para përulje (denigrim) dhe tallje u bë në Mekë, më pas bojkoti dhe uria në Shaab, dëbimi në Medinë dhe më pas luftërat e përgjakshme në Bedër e Uhud. Çdo lëvizje e kësaj bashkësie të vogël, kishte të bënte me mendimin e drejtë në kohën dhe vendin e duhur, donte të thoshte një faqe historie. Një shkrimtar në Europë do të shkruante: "Për popullin arab kjo ishte një lindje dhe kalim nga errësira në dritë. Arabia me këtë u rigjallërua, u ringjall. Një popull të varfër i cili që nga fillesa e tij bridhte i çoroditur nëpër shkretëtirat e veta, ishte taksur nga qielli që të dërgohej një kreshnik trim-profet, me një fjalë tek i cili ata mund të besojnë dhe shikoni: Ajo që ishte e panjohur, e njohu e gjithë bota, ajo që ishte e vogël, u rrit derisa u bë madhësi botërore. Vetëm për një shekull më pas Arabinë e gjejmë në Spanjë dhe nga ana tjetër në Indi. Duke shkëlqyer nga drita e trimërisë dhe nga shkëlqimi gjenial, Arabia ndriçon për një kohë të gjatë në një pjesë të madhe të botës. Feja është frymëzuese e madhe. Historia e një populli bëhet frytdhënëse, lartëson shpirtin kur këtë e beson populli (fenë). Këta arabë, ky burrë, Muhamedi dhe ky shekull – a nuk janë këta si një shkëndijë, vetë një shkëndijë që ra mbi një botë nga një shkëmb i zi..."

Shkrimtari është shprehur qartë: "Pranimi i Islamit donte të thoshte rilindje për popullin arab, lindja nga errësira në dritë, hyrje në histori. Por kjo është vetëm gjysma e ligjit. Gjysma tjetër e këtij ligji, lënia e Islamit, do të thotë kthim në errësi, zbritje nga skena historike. Historia argumenton se ky ligj nuk ishte i mirë vetëm për arabët, i tillë u bë edhe për turqit, persët, berberët dhe për popujt e tjerë të mjedisit islam. Ky ligj është i rëndësishëm edhe sot. Kështu në fund të kësaj ekspozije mund të themi se, duke festuar sot Mevludin, ne në të vërtetë nuk festojmë vetëm lindjen e një njeriu, por edhe ditëlindjen e një populli, ditëlindjen e shumë popujve, natyrisht, ditëlindjen e një civilizimi të madh.

Këtu qëndron madhështia dhe domethënia e kësaj dite të lavdishme.





Zemra jote **si toka e përhumbur**



Njerëzit flasin shpesh rreth përhumbjes (përkushtimit). Shpesh na rastis që ta dëgjojmë si fjalë dhe të thuhet se filani është i përhumbur (i përkushtuar), kurse ai tjetri nuk është i përhumbur dhe në të shumtën e rasteve, shohim që ata përshkruajnë gjendjen e përhumbjes ose rrugët që të çojnë drejt saj, por nuk i japin një përkufizim vetë thelbit të përhumbjes.

Atëherë, çfarë është përhumbja?

Po të vërejmë shumicën e atyre që flasin për përhumbjen, gjejmë se ata i qasen asaj vetëm nga një këndvështrim, vetëm nga një dimension, i cili përmbledhet tek e qara, nënshtrimi dhe përlësia, të cilat kanë si pasojë lotët e syrit.

Në fakt, përkushtimi dhe përhumbja e vërtetë është shumë herë më e madhe sesa pasojat e lartpërmendura, pasi përfshin shumë dimensione të tjera më rrezatuese, të cilat i japin kuptim real dhe efekt praktik.

Përhumbja e vërtetë është ajo gatishmëri për të marrë dhe kapur "fjalën e rëndë", është gatishmëri për të dalë nga errësirat në dritë, gatishmëri për ndryshim të vetes dhe ndryshim të botës më pas, falë ndërveprimit me Kur'anin dhe namazin. Në fund, është gatishmëria për të ndërvepruar me diskursin e Kur'anit, gjë e cila është në nivel zemre fillimisht, pastaj kalon edhe në nivel gjymtyrësh.

Për shkak dhe si pasojë e mallit të zemrës për përkujtimin e Zotit, me Kur'an apo namaz, njeriu përhumb në përgjërëm për Krijuesin.

Kjo përhumbje është aparenciale dhe e dukshme në përlësinë e zemrës dhe modestinë e saj para Kujdestarit të botëve, para Nurit të Tij të qartë. Menjëherë pas kësaj gjendjeje, kjo zemër, brof dhe mbushet me energji për jetën që e pret.

Pas një periudhe të plogësht, zemra e tij lulëzon, mbushet me gjelbërim. Ajo i ngjan tokës së përhumbur, e cila mezi pret erërat e ndryshimit dhe është duke u përgatitur për ndryshimin. E kur Zoti të lëshojë shiun, ajo shkundet dhe fillon të lulëzojë. Ai që e ngjalli tokën, do i ngjallë dhe të vdekurit, Ai është i aftë për gjithçka.

Po, do të shkundet dhe do të brofë zemra e tij, pasi fjalët që përmend janë të rënda, sepse i rëndë është amaneti që i është besuar nga Zoti i botëve. Pas kësaj, fjalët do të ndërveprojnë, do të lulëzojnë në zemër dhe fryti do të duket në jetën e re. Bima e re do të zhvillohet dhe lulëzojë, sa më shumë të zhvillohet dhe lulëzojë ndërveprimi me fjalët e Zotit. Ai që e ngjalli tokën, do i ngjallë dhe të vdekurit, Ai është i aftë për gjithçka.

Po, Ai është i aftë ta ngjallë zemrën tënde

nga vdekja, por gjithmonë me një kusht; gatishmërinë e saj për t'u ngjallur. Vetëm kështu mund të ngjallet dhe të lulëzojë jeta e vërtetë e kësaj bote.

Vetëm atëherë do të ndodhë ajo shkundja e madhe, fillimi i të cilës është në nivel zemre. Ajo do të përshkojë trupin, duke e bërë të brofë dhe të ringjallet pas vdekjes. Për shkak të shkundjes së madhe, do të rrëqethet lëkura e njeriut sa herë që lexon shenjat (ajetet) e të Gjithëmëshirshmit, nga fjalët e të cilit rrëqethen zemrat e atyre që e duan. Mandej, zemrat dhe lëkurat e tyre zbuten dhe qetësohen para përkujtimit të Zotit.

Nuk ka matës që mund ta masë forcën e kësaj lëkundjeje dhe shkundjeje, as "rihter" dhe as ndonjë tjetër. Matësi i vetëm i saj është realiteti që do të ndryshojë ky njeri, të cilin Zoti e ringjalli nga e para.

Si pasojë e fuqisë së fjalëve hyjnore të cilat e shkundën zemrën, vjen dhe e qara e vërtetë për shkak të dhimbjes së madhe. Pas saj, njeriu shpejton të kthehet tek Zoti i tij dhe të bëhet gati për të marrë dhe prituri fjalët e Tij. Kjo është pasoja e parë e përhumbjes. "Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin. Sigurisht, Ai i pranonte shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti." (Bekare, 37)

Pas kësaj, ndodh shkulja nga rrënjët e çdo bime të keqe dhe të prishur, për t'i krijuar hapësira bimës së re. Kështu njeriut i mundësohet një lindje e re, një krijim i ri. Zoti është Krijuesi më i mirë.

Si pasojë e përhumbjes së zemrës, përhumben edhe gjymtyrët e tjera, përhumbet syri, veshi dhe i gjithë trupi. Përhumbja thellohet më shumë sa më i lartë të jetë ndërveprimi i fjalëve me zemrën. E nëse njeriu përhumbet në këtë mënyrë, ndërveprimi i tij me natyrën do të jetë më i madh.

Zemra e përhumbur është baza e gatishmërisë, pikënisje e shkundjes dhe e rilindjes, katalizator i suksesit dhe i aktivitetit në jetë. Fatkeqësisht, në kemi pasur qasje negative karshi përhumbjes, ajo prodhoi gatishmëri për përlulje karshi Zotit, por nga ana tjetër prodhoi plogështi në jetë.

Vetëm me një zemër të përhumbur mund të kemi ndryshim, me kusht që të ketë gatishmërinë për të marrë dhe ndryshuar, për të dalë nga aktualiteti pasiv drejt një aktualiteti pozitiv më të mirë.

Nëse kjo zemër nuk është e gatshme për këtë, përhumbja e saj do të jetë naive, pa kuptim dhe pa objektiv, thjesht një shtirje, narkozë e vërtetë.

Përktheu: Elmaz Fida

KARAKTERISTIKAT E TË

Dërguarit të Allahut

Sipas transmetimeve, pamja e jashtme e Profetit të profetëve përshkruhet me këto fjalë: Ai kishte një trup të madh, i cili i jepte Atij një pamje madhështore. Gjymtyrët e trupit i kishte në raporte të ekuilibruara, pra krejt të natyrshme edhe në lidhjen që kishin me njëra-tjetrën. Fytyra i ndriçonte, seç kishte një vezullim të veçantë, sikur hëna e plotë. Ashtu siç nuk e kishte fytyrën të shëndoshë, as i rrumbullakët e topolak nuk ishte. Vetëm në fytyrë i dallohej një rrumbullakësi e lehtë. Ajo ishte fytyra më e buzëqeshur ndër të gjithë njerëzit. Trupi i Tij kishte një veçori që nuk bënte asnjëherë hije pas vetes. Edhe kur qëndronte përballë diellit, vezullimi i fytyrës së tij e mposhtte dritën e diellit. Kur kënaqej Krenaria e Njerëzimit, fytyra i shkëlqente sikur të ishte një copë prej hënës. Kësisoj kuptohej nëse ishte apo jo i gëzuar.

Nuk ishte tejet i gjatë, pak më i gjatë se një trup mesatar. Ndërsa ecte, dukej një njeri me trup të mesëm. Kur i afrohej pranë ndokush që ishte më i gjatë në trup, trupi i tij të krijonte përshtypjen se tjetri

ishte më i gjatë sesa Ai. Shpatullat i kishte të larguara nga njëra-tjetra. Vendet e kyçeve dhe shpinën i kishte pak sa të fryra. Jeleku që vishte, kur i binte poshtë shpatullave, ngjante njësoj si një mbulojë e argjendtë e derdhur mbi një kallëp të gatshëm. Mes dy kockave të shpatullave, pak më sipër asaj të majtës gjendej vula e profetësisë, e cila ngjante paksa me gjysmëhënë, paksa me vezët e pëllumbit, në një ngjyrë me lëkurën, e që rrinte në formën e një grushti.

Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte një gjoks të gjerë, i cili ishte në të njëjtën vijë me barkun. Nuk kishte bark të madh. Edhe shpinën, nuk e kishte as të mbushur, as shumë të dobët. Në bark kishte tri pjesë si ndarje të lakuara. Nga sipër gjoksit deri në fund të barkut kishte një si vijë të hollë qimesh. Nuk kishte të tjera të tilla, as në pjesë të tjera të gjoksit, as të barkut. Kishte, por më pak, edhe mbi supe apo mbi pjesët pak më sipër zemrës.

Gishtat e Resulullahut (s.a.s) ishin të gjatë dhe të hollë si shufra argjendi, me maja paksa të trasha,

pëllëmbë të fryrë, ndërsa kockat, si të duarve, ashtu edhe të këmbëve, i kishte krejtësisht të drejta. Me poshtësupe të mbushura, kocka krahësh të gjatë dhe kyçe të fryra mbi kockë.

Këmbët i kishte të mëdha. Thembrat vetëm fare pak të mishta. Nënkëmba ishte gropë, kurse pjesa e sipërme e butë dhe jashtëzakonisht e drejtë.

Koka e Profetit të Universit ishte jo e vogël, me flokët as të drejta e as me kaçurrela; diçka midis të dyjave, i dallgëzuar... Flokët i zbrisnin deri në mes të veshëve, e nganjëherë i kishte më të gjatë, aq sa i kalonin mes dy veshëve deri poshtë, duke u derdhur mbi shpatulla. Nganjëherë e ndante atë në mes, me balluket të lëshuara që i zbritnin deri fare pranë syve. Ndodhte që edhe t'i thurte flokët plot katër herë. Dy syresh i kalonte mbi veshin e djathtë, e dy të tjera mbi veshin e majtë. Veshët, që i dalloheshin pas flokëve të zinj, të kujtonin yjet e vegjël e vezullues. Kur e krihte me krehër, floku i bëhej vija-vija, njësoj si rrathët e formuar mbi rërën e shkretëtirës prej erës, apo valët e formuara mbi sipërfaqen e një uji kur hedhim diçka mbi të. Ngjyra e tyre ishte një e zezë e errët. Krenaria e Njerëzimit kishte një ballë të hapur e të gjerë, me një lëkurë të lëmuar dhe pa as më të voglën shenjë vrazhdësie.

Me vetullat të holla, të cilat i ktheheshin drejt cepave të syve, herë-herë të dukej sikur ato i bashkoheshin me njëra-tjetrën, e sikur nuk ishin të ndara. Në mes vetullave kishte një damar, i cili i fryhej sa herë që i duhej t'i mrrolte vetullat kur mund të ndodhte që të nxehej nga ndonjë gjë e pahijshme. Balli, kur i dukej më i hapur prej ballukeve, apo kur dilte përballë njerëzve në mbrëmje, i shndriste dhe vezullonte pors i një pishtar i ndezur.

E zeza e syve ishte plotësisht e zezë, ndërsa e bardha e bardhë dëborë; një e bardhë si të ish e përzier me të kuqen. Sytë i kishte të mëdhenj. Qerpikët të gjatë dhe të lakuar. Sytë e tij shikonin edhe ç'kishte pas, po ashtu siç shikonin çfarë gjendej përpara.

Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi Të) kishte dëgjim të plotë. Nganjëherë shikonte edhe ato çfarë të tjerët nuk i shihnin dot, e dëgjonte ato çfarë ata nuk kishin mundësi që t'i dëgjonin.

Hunda e Profetit të mbarë njerëzimit (alejhis'salatu ues'selam) ishte e gjatë, me mesin paksa të ngritur, majën të hollë, elegante dhe të drejtë. Kush e shihte për herë të parë, mendonte se e kishte hundën më të lartë dhe më të lakuar sesa një hundë e zakonshme. Faqet nuk i kishte të fryra, por as të zbrazëta. I kishte të drejta. Me pak tul, por me një lëkurë të lëmuar.

Goja e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) ishte e madhe, e gjerë aq saç duhet të jetë për t'u cilësuar elegante. Ajo bënte që dhëmbët e përparmë të ishin të dukshëm, të bardhë si kristal dhe të mprehtë. Dhëmbët e Tij të dukeshin sikur të ishin disa kokrra breshëri të

rreshtuara me rregull njëra pas tjetrës. Kur fliste, dhe ti ishe duke e dëgjuar, dukej sikur nga goja nuk i derdheshin fjalë, por një nur i ëmbël. E po ashtu njomështia e gojës së Tij ishte një tjetër çështje mrekullie apo dhurate e mirësisë hyjnore. Ajo erëmonte përherë një aromë të këndshme. Njëherë patën hedhur pak prej njomështisë së gojës së Tij mbi grykën e një pusi dhe uji i tij pati filluar të mbante një erë të mirë. Pikërisht me këtë pështymë ia pati fërkuar trupin e mbushur me puçrra Utbe ibni Ferkadit, i cili megjithëse nuk qe lyer me kurrfarë erëmore, mbartte një aromë tejet të këndshme. Edhe pusi që gjendej në shtëpinë e Enes ibni Malikut (radijallahu anhu) qe kthyer në depozitën e ujit më të ëmbël në mbarë Medinën.

Ai e kishte fytyrën me një mjekër të dendur, të shpeshtë dhe të madhe. Pjesën mes buzës së poshtme dhe mjekrës e kishte të hapur. Rreth e qark saj dalloheshin dy-tri fije të zbardhura, me një të bardhë si prej kristali. Edhe në flokë apo mjekrën në tërësi, veç tri-katër fije mund t'i dalloheshin si të thinjura. Nuk i pati lyer asnjëherë, as flokët, as mjekrën. Por edhe flokët nuk iu thinjën asnjëherë tërësisht. Allahu nuk ia zbardhi flokët, nuk deshë që ta tregonte të moshuar. Ato pak qime të thinjura të mjekrës rrinin aty pak më sipër fundit të mjekrës.

Lëkurën e kishte më se të lëmuar. Më e lëmuar edhe se mëndafshi. Me një erëimim më të ëmbël edhe se vetë aroma e miskut e amberit. Trupi i Krenarisë së Gjithësisë djsiste mjaft shpesh. Ummu Sulejmi ia mblidhte ndonjëherë djsën nëpër shishe të vockla, që më pas, duke i hedhur nëpër shishkat e aromave të mira, t'i bënte ato që mbanin erë akoma më të këndshme dhe me to bënte parfume. Daç të hidheshin ato parfume, daç të mos hidheshin, dora e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) do të lëshonte përherë një erë shumë të mirë; edhe dora e atij që shtrëngonte dorë me të gjatë ditës, mbante aromë gjer në mbrëmje.

Profeti ynë (s.a.s.) ecte shumë shpejt; sikur toka të përkulej për t'iu përshtatur këmbëve të Tij, që Ai të ecte sa më lehtësisht. Kushdo që rendte pas Tij e kishte të pamundur që ta arrinte. Nuk kishte hije pas Tij, as ditës për diell, e as natës për hënë. I qe pranuar menjëherë lutja që i pati bërë Allahut (xh.sh.): "O Zot, bëmë mua dritël!"

Krenaria e Njerëzisë kishte një zë kumbues, me një ton aq të ëmbël. Sahabët tregonin shpesh: "Na foli në Mina, dhe na bëri që të na hapeshin veshët. Madje ne arrinim t'ia dëgjonim zërin edhe që nga shtëpia." Ndonjëherë ndodhte që nga çardakët e shtëpive të Medinës të vinte zëri i ëmbël i Profetit fisnik teksa fliste në Faltoren Profetike. Ai ishte folësi më i qartë i gjuhës në mbarë arabët.

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"

M. Jusuf Kandehleui

Botim i KMSH

BAZAT E FITIMIT TË DIJES SË SHERIATIT DHE FIKHU I DA'UES

Thirrja Islame ka nevojë të madhe për dituri nga sheriatit dhe nga Fikhu; dhe mënyra se si ta aplikosh atë në aktualitet është tashmë e ditur. Por ama dituria kërkon baza mbi të cilat ajo ngrihet. Këto baza janë:

1.»A nuk i përket Allahut Feja e singertë»? (Ez-Zumer, 39:3). «Dhe ata nuk u urdhëruan për tjetër veçse që ata ta adhuronin Allahun me Besim të vërtetë e me sinqeritet.» (EL-Bejjineh, 98:5). Në Hadithin Profetik thuhet: «Ji i singertë në Fenë tënde që të të mjaftojë puna e pakët.» (Transmeton Hakimi). Shprehja «Ji i singertë në Fenë tënde» shpreh këtë kuptim: Pastroje Besimin tënd prej mangësive - dyshimeve dhe hipokrizisë - të cilat e pengojnë pranueshmërinë e saj; sepse çdo vepër tek e cila hyn mangësia - hipokrizia, dyshimi - është shirk dhe nuk pranohet. Ajo vepër nuk ka qenë lbadet – adhurim - për Allahun.

Sigurisht Allahu është i Gjithëmjaftueshëm dhe absolutisht i lartësuar dhe nuk ka nevojë për ortakë.

2. Përpjekja në kërkim e hulumtim për të arritur tek e vërteta dhe e drejta nëpërmjet ndjekjes së Sunetit. Domethënë është kërkesa e «la ilahe il-lall-llah» (nuk ka Zot tjetër përveç Allahut) që besimi të jetë i vërtetë, i sinqertë dhe adhurimi të jetë vetëm për Allahun.

Gjithashtu është kërkesa e «Muhammedun Resulull-lláh» (Muhammedi është i Dërguari i Allahut) që të kërkohej e të hulumtohet Suneti. Suneti i kohës së Profetit a.s.m. është ai që na është transmetuar neve. Sa për atë për të cilën janë përpjekur e përpiqen pas kohës së tij a.s.m. ajo është kërkimi dhe hulumtimi për të arritur tek konceptimi i drejtë i Sunetit nëpërmjet l'xhtihadit – interpretimit - të ligjshëm duke u nisur nga Libri i Allahut të Lartësuar dhe nga Suneti i të Dërguarit të Allahut, mbi të qofshin paqja dhe bekimet.

Mbi këto dy bazamente ngrihet puna. Domethënë, puna në të cilën është kënaqësia.

3. Leximi i universit me një lexim Hyjnor:

Ky lexim është marrë prej Fjalës së Allahut të Lartësuar: «Lexo! Me Emrin e Zotit tënd i Cili ka krijuar». (El-Alak, 96:1). Urdhri për lexim kushtëzohet me këtë kusht: «Me Emrin e Zotit tënd». Kjo shprehje është shprehja e «Bismil-láh» (Me Emrin e Allahut) e cila është një metodologji e plotë që vendos dogana për të penguar hyrjen e asaj që nuk duhet dhe për të penguar gjithashtu dërgimin e asaj që nuk duhet.

Shqipëroi nga arabishtja: Jusuf Salkurti



Gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme e **Kur'anit**

- Fjalët e Kur'anit janë vendosur në një mënyrë të tillë, saqë çdo frazë, çdo fjali, madje çdo shkronjë, e ndonjëherë edhe një sukun (boshllëk) ka shumë aspekte.

- Ai u jep çdonjërit prej atyre të cilëve ai u adresohet, pjesën e tij nga një derë e ndryshme. Për shembull ajeti kur'anor: "...Dhe (Ne i kemi bërë) malet si shtylla mbështetëse" (Kur'an, 78: 7);

Kjo është një frazë që nënkupton: "Unë i bëra malet si shtylla mbështetëse për tokën tuaj."

• PJESA e një njeriu të zakonshëm nga kjo frazë do të ishte:

Ai i shikon malet që duken si shtylla të ngulura në tokë; mendon për dobritë e mirësitë në to dhe i jep falënderime Krijuesit të tij.

• PJESA e një poeti nga kjo frazë do të ishte:

Ai e përfytyron tokën si një fushë mbi të cilën është ngrehur një hark i gjerë, kupa e qiellit, si një çadër e madhe jeshile e zbukuruar me llamba elektrike; i shikon majat e maleve si bazat e qiejve dhe sikur të ishin kunjat e çadrës; ai e adhuron Krijuesin e Gjithëlavdishëm me një çudi të mahnitshme.

• PJESA e një normadi elokuent nga kjo frazë do të ishte:

Ai e përfytyron sipërfaqen e tokës të jetë një shkretëtirë e gjerë; i përfytyron vargmalet si çadra nomadësh të shumta e të shumëllojshme; dhe sikur shtresa e dheut të ishte hedhur mbi shtyllat e larta, dhe majat e mprehta të shtyllave të kishin ngritur lart mbulesën e dheut, të cilin ai e shikon si banor i krijesave të ndryshme, duke parë njëri-tjetrin.

Kështu ai bie në sexhde i mahnitur para Krijuesit të Gjithëlavdishëm, i Cili i vendosi e i nguli kaq lehtë këto qenie madhështore e të fuqishme, sikur ato të ishin çadra në faqen e tokës.

• PJESA e një gjeografi me dhunti letrare nga kjo frazë do të ishte:

Ai e mendon globin tokësor si një anije duke lundruar në oqeanin e ajrit ose të eterit, ndërsa malet si direkë e pajorë të ngulur në anije për ekuilibrin dhe qëndrueshmërinë e saj.

Ai kështu mendon dhe pohon përpara Madhështisë së të Gjithëfuqishmit Absolut, i Cili e bëri globin e madh tokësor si një anije të mirëorganizuar; i Cili na vendosi ne në të, dhe e bën atë të udhëtojë në largësitë më të skajshme të universit, duke thënë:

"Lavdia të takon Ty, o Zot! Sa i lartë është Dinjiteti Yt!"

• PJESA e një sociologu dhe filozofi të shoqërisë njerëzore do të ishte:

Toka është një shtëpi, dhe shtyllat madhështore të jetës së asaj shtëpie janë jetët e gjallesave; ndërsa shtyllat mbështetëse të jetës së gjallesave janë uji, ajri dhe toka, të cilat janë kushtet e jetës; dhe shtyllat e drekët mbështetës të ujit, ajrit dhe tokës janë malet, sepse malet janë rezervuarët për ujë, janë krehrit për ajrin -sepse ato shtynjë e hedhin gazin e dëmshëm dhe e pastrojnë atë-; dhe janë mbrojtësit për tokën nga transformimi në moçalishte si dhe nga cenimi e shkelja e detit.

Për më tepër, malet janë thesaret për domosdoshmëritë e jetës njerëzore. Kështu, ai e kupton dhe me nderim e respekt të plotë i jep falënderime dhe lavdërime Krijuesit të Gjithëlavdisë e të Mirësisë, i Cili i bëri këto male të lartë si shtylla për tokën (shtëpinë e jetës sonë) dhe në këtë mënyrë i caktoi ato si ruajtësit e thesareve të jetës sonë.

• PJESA e një studiuesi të filozofisë natyrale nga kjo frazë do të ishte:

Ai do të mendonte për tërmetet e lëkundjet që ndodhin si rezultat i ngritjeve të shtresave dhe i bashkimit në brendësinë e tokës se ato qetësohen me shfaqjen e maleve, dhe se shkak i qëndrueshmërisë së tokës në boshtet e saja dhe në orbitën e saj, dhe e mos-devijimit në rrotullimin e saj vjetor si rezultat i tronditjes së tërmeteve, është shfaqja (dalja) e maleve.

Është sikur toka të merrte frymë me daljen e maleve dhe sikur të ulte zemërimin e të qetësohej.

Kështu, ai kupton, qetësohet dhe futet plotësisht në besim duke thënë:

"E gjithë urtësia i përket Allahut xh.sh!"



Mevludi

SI MANIFESTIM FETAR

Mevludi si krijim poetik kushtuar jetës dhe rolit profetik të Muhamedit a.s., zë vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë fetare të popujve myslimanë. Ky lloj i poezisë në një mënyrë zë fill me lirikët më të shquar të periudhës së Muhamedit a.s. – Ka'b bin Zuhejr dhe Hasan bin Thabit, të cilët u dalluan për panegjirikët e tyre kushtuar jetës dhe sukseseve të Muhamedit a.s. Poemat lirike të tyre qenë frymëzim për krijimtarinë e një numri mevludesh me tematikë identike në letërsitë orientale: arabe, persiane dhe turke.

Manifestimi i mevludit tek të gjithë popujt myslimanë fillon më 12 Rabiul-evuel, domethënë në muajin e tretë sipas muajve hënor. Arabët qenë të parët që qysh në shek. X filluan të kremtonin ditëlindjen e Profetit të Islamit. Në Egjipt gjatë sundimit të Fatimidëve (shek. XI) u organizua manifestimi madhështor për ditëlindjen e profetit Muhamed a.s. Në këtë fazë të parë të shënimit të

këtij manifestimi fetar islam, nuk ekzistonte ndonjë tekst a poezi kushtuar këtij manifestimi.

Si mevlud i parë të shkrimtarët myslimanë njihet kontributi i princit Ebu Seid Muzaferud-din Kukuburij, i cili më 1207 në Erbeli shënoi ditëlindjen e Profetit në mënyrë të organizuar. Në këtë manifestim morën pjesë personalitete të njohura shtetërore e fetare nga Bagdadi, Persia dhe Mosuli. Në ditën e shënimit të ditëlindjes së Profetit u mbajtën predikime fetare dhe u evokuan kujtime për rëndësinë e rolin e profetizmit të Muhamedit a.s. Kështu ky manifestim që i pari që shënoi ditëlindjen e Muhamedit a.s. e më vonë do të përhapej si një veprim tradicional, në tërë botën islame. Me këtë formë, mevludi u përhap shumë shpejt në Egjipt dhe prej andej në Mekë për t'u kthyer përsëri në Afrikë dhe për t'u përhapur për një kohë shumë të shkurtër që nga Fesi deri në Spanjë. Sot ditëlindja e Profetit a.s. shënohet



në botën islame arabe kryesisht nëpër xhami me ligjërata fetare, kushtuar jetës dhe rolit të Profetit a.s. Me këtë rast lexohen edhe poezi lirike në formë melodike kushtuar këtij personaliteti të madh.

Kremtimi i ditëlindjes së Profetit të turqit fillon në shek. XVI, pikërisht sulltan Murati III (1546-1595) që i pari që do ta shënonte këtë manifestim në oborrin mbretëror më 1588 e prej atëherë do të përhapej së pari në Turqi dhe më vonë në të gjitha viset e Perandorisë Osmane.

Nga mevlud i parë që u shkrua, për këtë kremtim ndër turqit, është mevludi i Sulejman Çelebiut, poet i njohur turk i shek. XV. Ky mevlud i parë turqisht, përveç lindjes së Profetit a.s., përfshin edhe dy ngjarje të rëndësishme të jetës së tij: ngjitjen në qiell (miraxh) dhe vdekjen e profetit. Kështu, mevludi i Sulejman Çelebiut, përshkrimin e jetës së Muhamedit a.s. e fillon me gëzime, duke përfshirë

të gjitha sukseset, për të përfunduar me një pjesë elegjiake për vdekjen e tij.

Mevludi në letërsinë islame shqiptare

Në shek. XVIII shqiptarët për herë të parë njohin formën e krijimit poetik islam në gjuhën shqipe, kushtuar lindjes së Muhamedit a.s. Letërsia islame shqiptare fillon me dy poemat fetare të Hasan Zyko Kamberit nga të cilat njëra bën fjalë për lindje, kurse tjetra i kushtohet ngjitjes në qiell (miraxhit) të profetit Muhamed a.s. Me sa dimë, kjo është përpjekja e parë për krijimin e një forme të mevludit në gjuhën shqipe me alfabet osman, sepse më përpara mevludi në mjediset islame shqiptare këndohej vetëm në gjuhën turke.

Dy poemat fetare islame – lindja dhe ngjitja në qiell (miraxhi) të Hasan Zyko Kamberit njihen si mevludi i parë në gjuhën shqipe nga disa studiues shqiptarë. Sipas mendimit tonë, këto dy poezi

bëjnë pjesë në vargun e gjatë të krijimeve poetike islame të Hasanit, por nuk paraqesin tërësinë e mevludit ashtu siç e njihnin shqiptarët mevludin e Sulejman Çelebiut, i cili ishte i vetmi në përdorim me një tërësi dhe brendi shumë më të gjerë. Roli i Hasan Zyko Kamberit në përpilimin e mevludit shqip me ato dy poezi do të ishte si roli i Ka'b bin Zuhejrit dhe Hasan bin Thabitit për nxitjen e shkrimit të mevludit tek arabët.

Mevludin shqip me një tërësi dhe brendi të bukur, e përktheu i pari Hafiz Ali Riza Ulqinaku me titull: "Terxhumei mevlud 'ala lisani arnavud" (përkthim i mevludit në gjuhën shqipe) shtypur në Stamboll më 1878. Siç vërehet edhe prej vetë titullit, ky mevlud që u botua në gjuhën shqipe me alfabet osman është përkthim i mevludit të Sulejman Çelebiut. Në vitin 1933 nën kujdesin e të birit, Hafiz Said Ulqinaku, po ky mevlud u ribotua me alfabetin shqip me titullin: Mevludi Sherif. Ky mevlud edhe sot lexohet te shqiptarët e Malit të Zi, të Shqipërisë së Veriut, si dhe në disa vise të Maqedonisë.

Një mevlud tjetër me rëndësi historiko-letrare, është ai i Tahir Popovës (Vuçitërnës) që është po kështu përkthim i mevludit të Sulejman Çelebiut me titull të rimuar Menz(dh) umetu-l-Mevlud fi efdali-l-Meug(xh)ud bi Lisani-l-Arnavud (Mevludi i rimuar, qenies së uruar, në gjuhën e shqipëruar), shtypur në Stamboll në gjuhën shqipe me alfabet arab. Ky mevlud është më shumë një përshtatje e mevludit të Sulejman Çelebiut, i cili më vonë është transkriptuar me alfabet shqip dhe përdoret më së shumti në Kosovë. Këto thurje poetike fetare të mevludeve kanë ngjashmëri strukturore të përbashkëta. Kështu në vargje shtjellohen ngjarjet: lindja e Muhamedit a.s., tema e profetizmit dhe roli i tij në këtë jetë. Në këtë mënyrë mevludi merr pothuajse tiparet e një krijimi epik. Mevludet e para në gjuhën shqipe me alfabet arab kanë vlerë historike për letërsinë shqipe, për arsye se që nga shek. XVIII fillonte komunikimi i mevludeve me masën shqiptare në gjuhën e tyre.

Mevludi në gjuhën shqipe u përhap shumë shpejt, sepse leximi dhe këndimi i tij bëhej nëpër tubime e manifestime të mëdha fetare. Me përhapjen e mevludit shqip përhapeshin edhe vlera gjuhësore e vlera të letërsisë shqipe. Shënimi i kremtimit të lindjes së Muhamedit do të vazhdojë të tërheqë interesimin edhe të poetëve të shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX. Kështu Hafiz Ali Korça lindjes së profetit Muhamed a.s. i kushtoi një

vepër të tërë qysh në vitin 1900.

Në këtë fushë dhanë kontribut edhe të tjerë shqiptarë të njohur, si Hafiz Abdullah Zëmbllaku dhe Hafiz Ibrahim Dalliu.

Mevludi i Hafiz Ali Korçës

Në krijimtarinë letrare islame të Hafiz Ali Korçës bën pjesë edhe Mevludi. Në krijimin e mevludit, Hafiz Ali Korça poemat e theksuara i përshtati në gjuhën shqipe duke mos iu përmbajtur gjithmonë tekstit të poemave në origjinal, kështu që në një mënyrë mund të konstatojmë se mevludi i tij është vepër origjinal dhe jo përkthim. Mendojmë se pikërisht këtu qëndron vlera historike e letrare e kësaj vepre poetike islame. Për radhitjen tematike, si duket, ai shfrytëzoi përvojën e Mevludit të Sulejman Çelebiut, i cili tashmë, jo vetëm që lexohej te shqiptarët, por ishte bërë pjesë e pandarë e jetës fetare në çdo tubim. Çdo radhitje tjetër tematike do të krijonte huti fetare, e cila mund të shpinte në ndonjë ndarje apo fraksion tjetër islam.

Mevludi i Hafiz Ali Korçës përbëhet prej 9 njësive tematike. Poema e parë fillon me pasqyrimin e fuqisë së Perëndisë, krijues absolut i botëve, dhe ka 52 vargje. Në pjesët Nuri i Muhamedit, Lindj' e Muhamedit, si u lint Pejgamberi ç'u bë, Nata q'u lint edhe qysh u rrit mbizotëron përshkrimi emocional lirik i profetit si fetar e jo mistik. Autori në mënyrë artistike i radhit ngjarjet më karakteristike të periudhës së Muhamedit a.s. Fitorja e Profetit, sipas autorit, është universale, prandaj jeta e tij është pasuri e të gjithëve:

Mirserdha të thanë bota an 'e mb 'onë Se shpresë për jetë vetëm ty të kanë.

Në këtë pjesë të mevludit të Hafiz Aliut paraqitet lindja dhe karakteri i Muhamedit a.s., një personalitet që përgatitej për marrjen përsipër të një misioni të madh islam dhe historik. Pikërisht ky mision përshkruhet në pjesën e dytë të mevludit me poemën "Si u bë Pejgamber", edhe "si e shkoj jetën". Kjo u kushtohet kohës dhe ngjarjeve gjatë shpalljes së Kur'anit që zgjati 23 vjet. Në këtë poemë prej 106 vargjesh autori me admirim flet për Kur'anin. Ai këtu duket sikur është pjesëmarrës i ngjarjes që përshkruan:

Ngreu dhe thirr botën të vinë në besë Edhe nis më parë të ftosh të Meqqesë! Kështu vjet njëzet e tre ec'e jakë Ja solli xhibrili Kur'anin nga pakë

Në poemë ka një numër personazhesh si Xhebrail Emini, Hatixheja, Beni Kahtani dhe Ademi. Të gjitha këto figura janë në funksion të ngjarjes së shtruar artistikisht. Xhebrail Emini është engjëll, përmes të cilit bëhet shpallja e Kur'anit, pra është një kryesore në relacion Perëndi-profet, kurse Hatixheja është bashkëshortja e Muhamedit a.s., së cilës më së pari ia kumtoi misionin e shpalljes. Beni Kahtan janë gjyshërit e Profetit ashtu si edhe Ademi, njeriu dhe profeti i parë në botë.

Vetëdija e formuar fetare dhe kombëtare e këtij autori nuk është veçse vazhdimësi e vetëdijes së paraardhësve të tij. Pikërisht Hafiz Aliu, në rrethana të reja dhe mjedise karakteristike fetare, është kujdesur që, përveç si frymëzim fetar, mevludi të ngjallte edhe dashurinë ndaj atdheut:

***Kur kujtonte Meqen Muhamed Muhtari
Çurk lotët e syve nga zjari
Nuk hante nuk pinte kujdesur nuk flinte
Vatanin e bukur nga goja s'e linte***

Hafiz Aliu, ndërkaq, do t'u drejtohet në formë të drejtpërdrejtë bashkëkombësve të tij:

***Zot! Le të na rrojë Atdheu' Kombësija
Aqë sa të rrojë edhe gjithësija.***

Në këto vargje bie në sy thirrja drejtuar shqiptarëve, të cilëve u jep si model personalitetin e Profetit a.s. për faktin se sa i dashur e i shtrenjtë është atdheu.

Autori udhëtimin e Muhamedit a.s. prej Mekës në Mesxhidi Aksa (Jeruzalem) dhe prej aty nëpër qiej, e përshkruan në poemën "Miraxhi i Pejgamberit". Hafiz Aliu në këto poema motivin e mori nga Kur'ani, ku theksohet se ky udhëtim është realizuar brenda një nate. Në poemë pasqyrohet udhëtimi dhe mënyra e udhëtimit. Në këtë udhëtim, Muhamedi a.s. kontakton me Perëndinë, por vetëm përmes bisedës, pa e parë. Poema ka 86 vargje dhe përfundon vetëm me një refren.

"Vdek' e Pejgamberit" është pjesa që mbyll Mevludin e Hafiz Aliut. Është poema më e gjatë në këtë Mevlud dhe përbëhet prej 116 vargjesh. Në këtë poezi elegjiake theksohet përfundimi i misionit të Profetit, sëmundja dhe, më në fund, vdekja e tij. Ajo që karakterizon këtë poemë, është qëndrimi ndaj vdekjes së Profetit, si një humbje për mbarë njerëzimin. Këto momente vërehen edhe në këto vargje:

***Aspo për të s'qanin vetëm njerëzija
Në qiell qanin ngjet në dhet bagëtija.***

Vlera të përgjithshme

Mevludi i Hafiz Aliut është shkruar me mjeshtëri të rrallë poetike dhe gjuhë të pastër shqipe. Në këtë kontekst do theksuar që kjo vepër letrare islame është mbështetur në përvojën dhe në kërkesat e popullit shqiptar për kohën kur u shkrua. Vepra është shkruar në vargje me metrikë të caktuar të poezisë së divanit në metrin, remel me masën: Failatun, failatun failun. Autori në Mevlud ka përdorur herë-herë disa arabizma, mirëpo përdorimi i tyre është në kontekst të përputhshmërisë së ritmit dhe rimës së poemës. Lidhur me përdorimin e këtyre pak arabizmave, në një mënyrë autori duhet arsyetuar, pasi këtu kemi të bëjmë me një lëndë të karakterit fetar, prandaj, përveç toponimeve, autori ka qenë i detyruar të përdorte edhe disa terma arabe, gjithnjë pa dëmtuar fare përmbajtjen dhe as strukturën e mevludit. Në katër raste ka përdorur pjesë të shkurtra të citateve të Kur'anit në origjinal, në përshtatje me temën që trajton, gjë që nuk rëndon tekstin shqip për lexuesin që nuk e njeh alfabetin arab:

***Ja dha (Ikre Bismi) in që ja kishte sjellë
U tremp Muhamedi shkoj dhe është
përshtjelle***

Apo:

***Për mbrojtur nderin' dinin e vërtetë
Mendohej e qante për vatan 'e vetë.
(Inna Fetahna Leke) gjer zbriti nga Zoti
Nga mubareq sytë nuk i pushoj loti.***

Përdorimi i zanores = ë = të theksuar (tënde, nëmë, lënk) në mevlud është mjaft i shpeshtë, sikur edhe i grupit zanor = ua = dhe rotacizmi (kaluar, lëvduar), që janë karakteristikë e toskërishtes prej nga vinte autori.

Mevludi i Hafiz Ali Korçës duhet shikuar si kthesë e re në truallin shqiptar për gjuhën dhe letrat shqipe. Mevludi i Hafiz Aliut ka vlerë historike e kombëtare, për arsye se është vepra e parë fetare me alfabet shqip e hartuar qysh para një shekulli me një gjuhë të rrjedhshme e të pastër shqipe. Kjo më së miri dëshmon që kemi të bëjmë me një autor, poet dhe shkrimtar me përvojë të madhe, me një njohës të gjuhës shqipe, të islamistikës dhe të letërsisë islame.

Mbi punën

Me këtë artikull do të prek se ç'asht puna, ç'randsi ka e ç'kanë thanë njerëz të përmendun për këte, për puntorin e përtacin. Pastaj me këte rast do të flas edhe mbi organizimin e puntorit ne vendet e qytetnueme e mbi faktorët që e kanë ba Shqiptarin me mos e pasë dëshirë punën.

Sikurse dihet, njeriu asht një antar i shoqnise njerzore e si ti tille duhet te kryeje detyrën e vet. Shoqnija dhe shteti e ka varë ekzistencën në bashkpunimin e të gjithë antarëve të vet. Sa ma puntorë të ndërgjegjshëm të jenë antarët, aqë ma tepër ka me u ndriçue e përparue familja, shteti e shoqnija. Prandaj njeriu duhet t'a bajë punën e vet me gëzim.

Po të shikojmë krijesat e tjera të Natyrës, si zogjt, mizat, merimangat, bimët, etj., kemi me pa se të gjitha kryejnë punët e veta e ruejnë sipas fuqis së tyne armonin e botës. Puna pra siç shifet, asht një ligj i përgjithshëm. Për ta kuptue këtë ligj, mjafton me hudh një sy për qark: I math e i vogël, burra e gra, nxanës e mjeshtër, të gjithë bajnë punë të ndryshme.

Puna ka randsi të madhe për shumë pikpamje: Kjo asht një nevojë materiale, sepse, për të sigurue njeriu nevojat landore, me anën e të cilave i ban ballë jetës, asht nevoja me punue. Me anën e punën kryhen, jo vetëm nevojat e para, si

ushqimi, veshja e banesa, të cilat i mjaftojnë njeriut primitif, porse edhe nevoja të tjera të njeriut të kohës së soçme, si ato artistike, intelektuale e shpirtnore, që masin shkallën qytetnore t'individave e të popujvet.

Puna asht edhe një nevojë shpirtnore, sepse ajo na hek mërztinë, e cila asht një nga armiqtë ma të rreptë të lumnisë së njeriut. Ata që nuk punojnë e që humbasin kohën kot, nuk munden kurrë me gjetë një prehje shpirtnore. Të ndejtunit kot, pa ba kurrfarë pune, e shtyen njeriun me ba keqsina, se përtimi asht nana e te gjitha të kqijave. Porse puna asht edhe një nevojë morale e shoqnore. Na jetojmë në shoqni, në të cilën jeta e jonë asht e siguresme në punimin e atyne që kanë vdekë e t'atyne që jetojnë në një kohë me ne. Prodhimet ma ornare, si buka, libri etj., janë punimet e sesa të vekunve e të gjallëve. Pa bujkun, pa të dijtshmin, etj., na s'kishim me i gjetë gati këto që kemi. Pa çpikësit e shkrimit, të letrës, të shtypshokronjës, etj., pa interpretonjsit, që na komunikojnë çpikjet, shkenca a ditunia s'kishte me qenë e mundun; njerëzia s'kishte me dalë prej gjendjes primitive.

Puna, m'anë tjetër, siguron indipendencën personale, nderin e lumnin: Ajo na ban të jemi të lirë e të pavarur në një shoqni të rregullueme mirë. Njerzit që kryejnë punë të ndryshme, mbajnë vehten e familjen, pa iu ba barrë shoqnisë, në të cilën jetojnë. Puna

pastaj asht edhe një mjet mjaft i mirë për me pasë një disiplinë shembullore. Jeta e përditshme na e vërteton se ata që e humbasin kohën kot apo duen me punue, po s'kanë se ku e se si, se shteti nuk u gjen punë e nuk na siguron shpërblimin e mundimit, bahen të kqijë: çpikin mjete të poshtme, për me fitue jetesën, bahen spijuna, shesin votë, ke e cila varet e mira e kombit, bahet vasalet e fuqishmëvet, etj. përkundrazi, nëpër ato shtete, ku banorët bajnë punët e veta rregullisht, qetsia mbretton, qytetnimi përparon me hapa të shpejta, morali forcohet, vuajtje e mjerime s'ka e jeta asht e kandshme.

Nga këto që u përmendën, kuptohet se puna asht edhe një mjet për m'e ba njeriun të lumtun: ajo i shton atij gjallnin, i forcon trupin e ban të moralshëm, i jep shkathësin ë durvet e të mëndjes e ban që të ketë një shpirt të math.

Tue marrë parasysh randsinë e veprat që kryhen me anën e punës, shumë sociologë të ndryshëm kanë çfaq mendime mbi punën, puntorin e përtacin. Voltaire ka thënë: "Puna na largon tri të këqija të mdhaja: mërzhitinë, vesin e keq e vobegsinë". "Ai që nuk punon, thotë njeni, nuk duhet të hajë". J.J. Rousseau i thotë: "Me punue asht një detyrë e domosdoshme për njeriun e shoqnise njerzore. Nënshetasi përtac, që nuk ban as punë landore as punë mendore, qoftë i pasur a i vobegtë, qoftë me pozitë të naltë a t'ulët asht parazit". Muhamedi thotë: "Perëndia dënon dy njerëz pa faje të dukëshme: përtacët e gryksit. Kjo do të thotë se, edhe sikur të jetë njeriu pasanik, duhet të punojë. M'anë tjetër nuk duhet me hangër gjana të tepërta, që nuk i sjellin dobi trupit. Me fjalë të tjera me shigue çdo lloj gjelle të mirë e të kushtueshme, kurse të tjerët nuk kanë kafshatën e bukës, asht një gjë e panjerzishme. Muhamedi, kur pa se populli ipesh shumë mbas detyrave fetare, saqë pat frikë që të lehesh puna pa u ba, tha: "Puno për këtë jetë sikurse ke me jetue përgjithmonë, puno edhe për t'ardhshmen t'andë sikurse ke me vdekë nesër". Siç shifet në këtë të thanme janë dy urdhna: në të parin i thotë bestarit të punojë gjithnji e me mjetet të ndershme, që të mos u bahet barrë të tjerëvet. Në të dytin thotë që të kryejë edhe detyrat fetare, si pasurin e fitueme hallall ta shpenzojë për nevojat njerzore, për bamirsina, për ndihmë, etj. e

jo t'a grumbullojë vetëm për vehten e vet, sikurse me pasë me jetue gjithmonë.

Muhamedi prap thotë: "Fituesi me mjete të ndershme asht miku i Perëndisë". Ai thotë prap: "Sa pasuni e vlefshme asht ajo e burrit të ndershëm". Kjo do të thotë se pasunia e fitueme me mjete të ndershme, ka vleftë vetëm atëherë, kur i zoti i saj asht njeri i mirë e ve atë në përdorim për dobina njerzore. Ai ka thënë prap: "Nuk ec anija në të thatë". Kjo don të thotë se, ma se ec anija në tokë, aqë vazhdon jeta pa frytin e punës. Nji verseti i Kuranit thotë: "Nuk ka tjetër shpëtim për njeriun vetëm se me u përpjekë e me punue". Nji proverbë arabe thotë: "Kanë mbjellë të tjerët para nesh, që të hamë na sot, të mbjellim na që të hanë ata që vijnë mbas nesh".

Mbasi puna ka randsi të madhe, se ke kjo varet përparimi landuer, shpirtnuer e menduer i nji kombi, kuptohet vetiu se asht detyrë morale, njerzore e patriotike, që të gjithë nënshetaset, që janë në gjendje mendore e fizike, të bajnë punët që u përkasin, që kështu të mundet me i këthye shoqnisë atë që i kanë marr e me ba për t'ardhmen jo vetëm atë që kanë ba të parët e tyre puntore, por edhe ma tepër, që të zhvillohet e të përparojë sa ma shpejtë e ma mirë shteti e shoqnija.

Mirë po kjo gjë nuk asht e mundun për herë e në gjithë vendet. Në disa shtete ka njerz të papunë, ka edhe me punë. Disa nuk janë përtacë, përkundrazi janë energjikë, po s'kanë se ku të punojnë, se toka a tregtija u mungon, kurse disa të tjerë kanë me qindra hektarë e lanë djerrë. Disa punojnë gjithë ditën e s'u del me hangër bukë e krypë, kurse ca të tjerë ushqehen me çdo lloj gjelle të shijshme e çojnë nji jetë luksoze, pa punue fare. Disa jetojnë në pallate, kurse ca të tjerë po pranë këtyne pallateve jetojnë në mizierje si njerzit ma primitiv. Disa marrin shuma të majme e nuk i bajnë kurrfarë shërbimi njerzisë, kurse disa të tjera e shkrijnë të gjithë energjinë e tyne mendore e fizike për nji mëditje a rroge të vogël, sa me mbajtë me frymë fëmijt etj. Disa të tjerëve nuk u jepet a ngarkohet puna që mund ta kryejnë mirë, por përkundrazi atyne që ta lajnë metë a mos ta bajnë fare. Disa shkojnë në zyrë, jo për punë serioze, por vetëm për burokrasi, me dhanë urdhna të papërshtatuna që mbesin n'arshivat, apo shkojnë sa për idarei

masllahat e me zhustifikue (me ba hak) rrogën, etj.

Nga këto padrejtsina, mosbarazime e çrregullime janë shkaktue mosknaqsina, kanë dalë grindje, kanë plasë revolusione e janë ba ndryshime regjimesh. Kso shembullash historiaja na tregon shumë qush prej Revolucionit Francez e këndej. Me të zhdukunit e padrejtsinavet me vendosjen e stabilizimin e qetsise, me të organizue punën e puntorin me të vendosunit e një programi, që ka për qëllim naftsimin e kombit fizikisht, shpirtnisht e moralisht, ata shtete kanë ba përparime të çuditëshmë për një kohë të shkurtër, përparime që të parët e tyne nuk kishin mund me i ba me shekuj.

Pra për të shkue mbarë puna asht nevoja ma parë për një organizatë shoqnore të rregullueme me parime njerëzore. Në qoftë se s'ka një plan e sistem punimi, në qoftë se punës mendore a trupore s'i epet randsi, në qoftë se maqina shtenore s'ecë mirë, atëherë vetvetiu puna lehet pa u ba apo kryhet me të meta.

Mjafton me i hudh një sy historisë së re për të kuptue shkallën e përparimit të disa shteteve, që kanë mujtë me çdukë grindjet, padrejtsinat e kanë vendosë një organizatë shoqnore të rregullueme me parime kombtare. Me këtë rasë asht mirë me përmendë përparimet madhështore që ka ba mbrenda pak vjet Perëndimi, jo për gja tjetër, po vetëm me marrë shembull, sikurse thotë edhe Kurani: "Merrni shembull ju që dini të shikoni".

Nashti të mendojmë pse Shqiptari nuk e ka pasë dëshirën punën. Për këto gjana, natyrisht, asht nevoja me i hudhë një sy shkurtazi Historisë së Shqipnisë. Siç dihet, Shqiptari ka qenë gjithmonë në robni; këtë e kanë shkelë shumë popujtë ndryshëm,

të cilët kanë ndjenjë me qindra vjet. Në Mesjetë kishte sistemin feudal, sikurse n'Evropë. Në kohën e Skanderbeut Shqipnija qe një nga vendet ma të para që e hoqi sistemin feudal, tue i ba të gjithë princat a sundonjësit e krahinave të bashkoheshin e të luftojshin së bashku armikun. Me gjithë këtë nuk pati ndonji përparim, mbasi burrat gati s'u muerën me punë bujqësore nga shkaku i luftavet. Mbasi e pushtuen krejt Shqipnin, shumë Shqiptarë lanë plang e shtëpi e u vendosën në vende të hueja. Ata që mbetën në Shqipni, e çuenë kohën me kryengritje kundra armikut, që u erdhi në votër. Gjatë sundimit turk, nëpër fusha popllsia u rralue, se toka filloi me iu grabit, shumica dul nga zotnimi i mallit e u ba ujk. Prodhimet bujqësore ma të mira bujku i shkretë nuk i gëzonte me fëmijët e vet. Nëpër malsina nga mungesa e tokës pjellore e vobegsia e tepërt shumë nga banorët shkojshin nëpër vend të hueja me gjet punë; katundari i shkretë shkonte në Stamboll me punue për tre grosh në ditë. I riu korçar linte prindrit e nusen e re e shkonte n'Amerikë. Atje me njimijë mundime punonte nëpër miniera, flente e hante keq sa që bahesh edhe verem. Të hollat e kursyeme ia dërgonte shtëpisë.

Me këtë mënyrë për Shqiptarin u përsërit Koha e Mesme, e cila zgjati me shekuj: as rrugë, as përparim, as arsim. Vendin e shkollave në disa qytete e shkolla të paorganizueme, në të cilat shumica shkonte, jo për me msue fenë e vërtetë, por vetëm për të shpëtue nga ushria e të mos paguente taksa rruge. Kështuqë, pa dashje, ata u banë fole përtacësh e parazitësh. Këta parazitë, pa me ditë gja nga feja, lidhshin nga ji çallmë e u shpërndasjshin nëpër katunde, tue predikue gjana fatale e tue ia mohue nacionalitetin atij populli

të shkretë, që ka pasë derdhë gjak pa kursim për të mbrojtë Atdheun. Kurse Feja Islame thotë: "Kush don Atdheun ka besue në Perëndinë". Populli i padijtun tërhiqesh kollaj sa nga një anë edhe në tjetrën.

Poeti i jonë kombtar Naim frashëri, tue pa se në këtë kohë s'kishte kurrfarë përparimi e kurrfarë pune tha: "Punë punë nat e ditë që të shohim pak dritë". Edhe si u ba Shqipnia e lirë nuk përparoi aq sa duhesh mbasi ra nër duert e njerëzve të paaftë, të cilët sjellin shkatrrimin sikurse thotë edhe Muhamedi, "kur puna të bjerë nër duert e njerëzve të pazot pritni shkatrrimin". Kultura e puna mendore s'përkrahesh fare, sepse vendet me pozitë i kishin zanë njerzit e paditshëm. Vepra morale e letrare nuk shtypeshin, se ishin kundra ndjejavet t'atyne që e spekulojshin popullin n'emën të nacionalizmës së fesë. Shtypi kishte ra në dorë të të shiturve. Shumica e nëpunsve emnohesh pa karrierë e pakurrfarë zotsie; natyrisht këta farë nënpunsish janë mercenarë dhe i shërbejnë vetëm interesit të tyne. Luksi kishte mbrijtë kulmin në disa persona të paktë, të cilët e kishin ba çiflik Shqipninë e shkretë. Populli i ulët i Shqipnisë vuente nga çdo pikpamje. Populli s'kishte as ujë me pi, e ishte në mëshirë të mikrobit të tifos. Bujku ishte i mjerë. Jetesa e tij ishte në një gjendje të vajtueshme: prodhimet bujqësore i shiste në lamë fare lirë pastaj ma vonë, nga nevoja këtheshte dhe e blinte 4 fish ma tepër nga spekuluesit, etj.

Kto janë shkaqet që e kanë ba shqiptarin m'e humbë vullnetin, dëshirën e kurajën për punë. Prej natyre Shqiptari e don punën e ka çpikë proverbin: "As armikun mos e pafshë pa punë".

"Kultura Islame", Nr. 6-7, Mars 1940, fq. 216





HASAN SELAMI

(1910-1943)

TEOLOG, STUDIUES DHE ATDHETAR I SHQUAR

Hasani ka lindur në fshatin Kallarat të rrethit të Vlorës më 1910. Shkollën fillore e kreu në fshatin e vet, në shtëpinë e kushëririt të tij, Bajram Bajramit, rreth vitit 1922. Shkollën qytetëse (7 vjeçare) e kreu në Vlorë duke punuar e shërbyer në dyert e të pasurve, për të siguruar bukën e gojës si dhe për të fituar dijet e nevojshme. Pastaj i doli e drejta e studimit për të vazhduar Medresenë e Përgjithshme në Tiranë. Në vitin 1935 kreu studimet në Medrese duke u diplomuar me gradën "E Lavdërueshme". Ai ishte shumë i aftë sidomos në mësimin e gjuhëve të huaja. Kishte sjellje shembullore, ishte i shoqëruar e i përvuajtur. Shkolla e pajisi Hasanin, si të gjithë nxënësit që studionin në të, me ndjenja të thella fetare e kombëtare.

E gjithë jeta shkollore e tij qe studim e mirësjellje. Me këto virtyte të shquara fitoi admirimin e shokëve,

dashurinë e profesorëve dhe simpatinë e drejtuesve të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Që kur ishte ende nxënës në Medrese ai jepte mësim në klasat e ulëta të kësaj shkolle dhe me mbarimin e studimeve në të, u emërua vaiz shëtitës në dispozicion të Komunitetit Mysliman, duke qenë edhe asistent profesor në Medrese. Për gati dy vjet vazhdoi të predikonte në xhamitë e Tiranës, Durrësit, Kavajës, Lushnjës, Fierit, Beratit, Elbasanit, Pogradecit, Korçës, Gjirokastrës etj. Në predikimet që bënte Hasani, sipas njoftimit që bënte myftinia e rrethit përkatës, merrnin pjesë, përveç popullit mbarë, edhe intelektualë të qytetit, pa dallim besimi. Të gjithë largoheshin të kënaqur, sepse temat që zhvillonte e nxisnin popullin nga puna, qytetërimi dhe morali. Ato ishin prekëse, të bazuara në Kur'an e në porositë e Hz. Muhamedit (a.s.),

të vërtetuara e të zbukuruar me fjalët e shumë dijetarëve islamë ose nga ata të perëndimit. Me temat që trajtonte, ai i tregonte botës shqiptare se Medreseja e Përgjithshme përgatiste kuadro të shquar.

Kryesia e Komunitetit Mysliman Shqiptar mendonte t'i jepte detyra nga më të lartat që lejonte rregullorja e shkollës, por Hasani nuk donte detyra, ai donte të shtonte dijenitë fetare e të përgjithshme. Prandaj, aty nga mbarimi i vitit 1936 shkoi në Egjipt dhe u regjistrua në Universitetin e Ez'herit në Kajro. Profesorët, duke u mbështetur në aftësitë e tij, si dhe në përvojën e fituar kur ishte vaiz shëtitës në Shqipëri, pranuan që ta regjistronin student të rregullt në specialitetin e vaizit dhe të irshadit.

Hasan Selami zotëronte virtutet të lartë dhe moral të pastër. Ishte i aftë, i pastër, i ndershëm, i sinqertë, modest, serioz e i vullnetshëm. Nuk e kalonte kohën kot dhe dëshironte, duke qenë student, të kryente plotësisht misionin që i kish ngarkuar Komuniteti Mysliman.

Ai në të njëjtën kohë u regjistrua edhe në Universitetin Amerikan të Kajros, në degën e letërsisë e të pedagogjisë. Edhe aty kishte fituar një simpati të madhe.

Ishte njohës i arabishtes, anglishtes, persishtes, frëngjishtes e italishtes, të cilat i zotëronte në mënyrë perfekte.

Në verë të vitit 1939 fitoi doktoraturën në "Predikim e Thirrje në Islam". Fotografia e këtij studenti shqiptar zbukuroi faqet e disa fletoreve të përditshme të Egjiptit, megjithatë ai nuk krenohej aspak për titullin e studimit që kish fituar. Ai gjithmonë shprehej: "Dituria s'ka fund dhe unë di vetëm që s'di asgjë".

Në verë të vitit 1939 erdhi në Shqipëri e qëndroi vetëm dy muaj. Ai nuk kishte ndërmend dhe as që mori ndonjë detyrë. Qëllimi i tij kryesor ishte që të vazhdonte studimet e të kryente edhe një ose më tepër fakultete të tjera në Kajro. Në vjeshtë të vitit 1939 shkoi përsëri në Egjipt, me bursë të Komunitetit Mysliman për të studiuar "Historinë Islame", d.m.th. për të fituar edhe një specializim në këtë degë. Shkoi përsëri në Kajro për të mos u kthyer më, për të mbetur përgjithmonë në dhe të huaj.

Hasan Selami Kallarati ndërroi jetë në Kajro më 15 korrik 1943, në moshën 33 vjeçare. Periudha nga 1939-1943 janë plot katër vjet shkollë. Sigurisht, gjatë kësaj kohe i ndjeri Hasan do të ketë bërë punë të madhe. Mirëpo vdekja, që është rrugë për t'u përshkuar nga të gjithë, ia preu hovin duke e ndarë nga kjo jetë në një moshë që ishte mbushur me dije. Me okupimin e vendit tonë nga Italia

fashiste, ai si atdhetar përparimtar, grumbulloi rreth vetes shumë studentë të huaj e shqiptarë dhe shkoi e protestoi përpara përfaqësive të huaja të akredituara në Kajro, duke thënë midis tjerash: "Ç'kërkon fashizmi italian në Shqipëri, ajo nuk i ka borxh askujt, prandaj ata duhet të kthehen nga kanë ardhur" etj.

Hasani, duke qenë me studime në Kajro, ka pasur korrespondencë për çështje gjuhësie me rilindasin e studiuesin Sotir Kolea, i cili ka edhe një korrespondencë me letra që daton më 10 korrik 1937.

Duke qenë nxënës në medrese dhe predikues, ai ka dhënë një kontribut të madh me shkrimet dhe përkthimet e veta në revistat fetare-kulturore "Zani i Naltë", "Kultura Islame", siç mund të përmenden artikujt "Ç'urdhëron Perëndia në Kur'an", ku, pasi komentohet sure "El Asr" shprehen mendime të tilla si: "Do ta përparojmë e do ta lulëzojmë atdheun, nëse do të kemi frikën e Perëndisë, do të mbajmë sedrën e shqiptarit e do të pajisemi me vullnet të fortë", ose "E kemi detyrë fetare të përvetësojmë e të përgjithësojmë çdo përparim... përparimin madhështor të perëndimit".

Në artikullin "E vërteta mbi xhizjen" thotë se ajo është një taksë që paguhet si shpërblim për mbrojtjen e jetës dhe të pasurisë së nënshtetasve jomyslimanë (të kujton institutin e sigurimeve sot në vendin tonë).

Nga "The light" në 13.5.1932 ka përkthyer vjershën kuptimplotë "Profeti dhe jahudiu". Janë për t'u përmendur në një rast 20 fjalë të arta të Hz. Aliut nga të cilat po shkëpusim tre: "Mos u dëshpëro për vonimin që shkatohet në pranimin e lutjes sate, se, sa më shumë të jetë vonimi, aq më e madhe bëhet dhurata"; "Mos iu frikëso asnjë gjëje veç mëkatit tënd e mos i zë besë askujt veç Zotit të plotfuqishëm" dhe "Mëso dituri prej cilitdo që ta mëson, çmoje vlerën e diturisë dhe mos mendo cilësinë e mësuesit".

Nga shkrimet e përkthimet e shumta të tij, do të veçojmë edhe vjershën "Hymni mysliiman shqiptar", botuar nga Imam Vehbi Ismaili në librin "Islamizmi dhe lutjet" (botim i tretë i përmirësuar) nga mund të shkëpusim vargjet:

"Unë në shpirt
e kam dashurinë e fesë,
i lutem, pra, Zotit,
mysliiman të vdes".

Idealet e Hasan Selamit do të kurorëzohen në jetën e pasosur sepse Profeti (a.s.) ka thënë: "Ai që vdes duke kërkuar dituri, vdes dëshmor (shëhid)".

Kjo figurë poliedrike islame, do të jetë shembull i madh për të gjithë nxënësit e sotëm e të ardhshëm të medreseve në Shqipëri!

EDUKIMI FILLON NË

familje

Fatkeqësisht në ditët e sotme është shtuar ndjeshëm numri i personave të ekspozuar ndaj dhunës në mënyrë direkte ose indirekte. Dhuna verbale, psikologjike apo fizike është një virus më i rrezikshëm se virusi i kalur gjatë kohës së pandemisë.

Dhuna, një akt shkatërrues

Ashtu si ndjenjat e tjera edhe zemërimi bën pjesë në grupin e ndjenjave themelore të njeriut, por shprehja e tij verbalisht apo fizikisht mund të sjellë pasoja të pakthyeshme. Shumica e njerëzve arrijnë të kontrollojnë zemërimin dhe ta shprehin atë në mënyrat më të pranueshme nga ana e shoqërisë. Mësimi i vetëkontrollit fillon që në familje. Çdo sjellje fizike apo psikologjike e cila dëmton të tjerët, përkufizohet si një sjellje agresive. Rrjedhimisht mund të themi se dhuna përfshin brenda vetes sjelljet agresive. Ndërsa dhuna vetë është një pengesë e fortë në zhvillimin bio-psiko-social të njeriut, duke i hapur rrugë plagosjes ose vdekjes së individit. Dhuna është një akt shkatërrues, qofte ajo psikologjike apo fizike, s'ka rëndësi nëse ushtrohet ndaj gjallesave apo sendeve. Dhuna është një pasojë dhe ne mund ta luftojmë apo shmangim atë vetëm atëherë kur njohim shkaqet e saj. Një qëndrim i dhunshëm lidhet me qëndrimin e gabuar të prindërve, me gjendjen socio ekonomike, strukturën shoqërore, normat e vendosura sociale e shumë faktorë të tjerë.

Struktura familjare e rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve

Eksperiencat e para sociale të fëmijës përjetohej në familje. Edhe krijimi i personalitetit të fëmijës realizohet duke marrë si model prindërit apo pjesëtarët e tjerë të familjes. Në këtë mënyrë struktura familjare luan një rol të rëndësishëm dhe përcaktues në zhvillimin emocional dhe shoqëror të fëmijës. Në këtë pike qëndrimet e prindërve luajnë një rol vendimtar. Fëmijët e rritur në familje mirëkuptuese dhe të ndjeshme janë më të aftë të shprehin ndjenjat dhe mendimet e tyre. Është vënë re se këta fëmijë janë më të aftë të praktikojnë njohuritë e marra. Në anën tjetër, në familje autoritare dhe të rrepta vihet re një prirje agresive e fëmijëve në shprehjen e mendimeve e ndjenjave dhe në shumicën e rasteve mbyllje në vetvete. Një fëmijë i rritur nën kontroll të tepruar, në të ardhmen mund të ndjejë nevojën e të qenurit i kontrolluar nga dikush ose të kontrollojë të tjerët rreptësisht. Në marrëdhëniet e krijuara në vazhdim do të pasqyrojnë një qëndrim të ftohtë, autoritar, të dyshimtë dhe mosbesues. Prindërit duhet të mbajnë një qëndrim të sigurtë, mbështetës dhe solidar për një zhvillim të shëndetshëm psikosocial.

Fjalët lënë shenja

Një fëmijëri e lënë pas dore, theksimi i veprimeve negative më shumë se ato pozitive, zhgënjimi, kritikët dhe moskontrollimi i zemërimit janë disa nga faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Dhuna fillon me fjalë dhe më pas kalon në akte. Përpikuni të qëndroni

A close-up photograph of a hand holding an open children's book. The book is tilted, showing two pages. The left page features a vibrant illustration of a red dragon-like creature in a landscape with green hills and a blue sky. The right page shows a cartoon panda sitting on a blue and white checkered blanket, surrounded by various toys and objects. The background is softly blurred, showing a wooden floor and a white wall.

larg kritikave lodhëse kur fëmija juaj bën një veprim të padëshiruar apo thotë një fjalë të pavend. Një fëmijë, nevojat emocionale e psikologjike të të cilit nuk janë plotësuar në shtëpi, do të përpiqet t'i plotësojë në shoqëri. Nisur nga kjo, sjelljet e dhunshme janë një pasqyrim i mosplotësimit emocional. Për shembull: Një fëmijë i cili e sheh veten të lënë pas dore pas lindjes së vëllait, përpiqet ta plotësojë këtë boshllëk emocional duke dëmtuar të vëllanë apo gjërat rreth tij. Prandaj prindërit duhet të tregohen shumë të kujdesshëm në këtë pikë dhe të vëzhgojnë me kujdes reagimet e fëmijës me të madh.

Përpiquni të jeni të qëndrueshëm në marrëdhëniet tuaja, qëndrimi apo sjellja juaj është më efektive se fjalët e thëna. Për shembull: Nëse ju kërkoni nga fëmija të mos godasë njeri me dorë, të mos dëmtojë objektet rreth tij dhe në të njëjtën kohë, bëni të kundërtën, atëherë e fusni fëmijën tuaj në një dilemë të vështirë. Pika kryesore këtu nuk është vetëm sjellja e fëmijës ndaj ambjentit por edhe marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, mënyra se si të rriturit kërkojnë zgjidhje për problemet mes tyre. Kur fëmijët shohin se prindërit e tyre përdorin dhunën në zgjidhjen e problemeve, në të ardhmen do ta përdorin si një zgjidhje natyrale, sepse fëmijët janë të prirur të mësojnë nga veprimet e jo nga fjalët tuaja. Si rrjedhojë, dhurojini fëmijëve siguri, bëhuni udhërrëfyes për ta dhe një model i drejtë. Plotësoni nevojat dhe dëshirat e tij dhe tregohuni sa më mbështetës ndërkohë që përballet me probleme të ndryshme.

MEKANIZMAT MBROJTËS NË *enët e gjakut*

Gjaku i cili pompohet nga zemra, rrjedh nëpër enët e gjakut drejt të gjithë organeve dhe transporton oksigjenin dhe përbërësit ushqimor në të gjitha qelizat e organizmit. Në gjendje normale rrjedhja e gjakut nëpër enët kryhet lirshëm, pa asnjë pengesë gjatë rrugës dhe kjo është jetike për shëndetin e organizmit. Nëse muri i enës së gjakut dëmtohet, aty gjaku fillon të mpikset duke përbërë një proces fiziologjik natyral shumë të rëndësishëm të mbrojtjes së tyre. Normalisht, hemorragjia nga trauma ose nga sëmundjet e ndryshme ndalohet nga formimi i trombit, që është rezultat i koagulimit të gjakut për gati 5 minuta. Ky proces mbrojtës i vendosur në trupin tonë nga Allahu i Gjithëdijshtëm, parandalon rrjedhjen e lirë të gjakut jashtë enës, në mungesë të së cilit i gjithë gjaku jonë do të dilte jashtë derisa të zbrazej plotësisht. Meqë dëmtimet e vogla të enëve të lëkurës janë pjesë e jetës së përditshme dhe pothuajse janë të pashmangshme, atëherë jeta do të ishte gjithmonë në rrezik po të mos ekzistonte ky mekanizëm mbrojtës. Pra, mpiksja e gjakut në enën e dëmtuar është një mirësi, por nëse mpiksja do të

vazhdonte për shumë gjatë, atëherë ajo do ta bllokonte në mënyrë të shpejtë gjithë hapësirën e vogël të enës së gjakut duke e bërë rrjedhjen të pamundur. Dikush mund të mendonte se me kalimin e shumë viteve ena e gjakut do të çahet nga rrjedhja e fuqishme e gjakut sidomos në arteriet, por Zoti i gjithësisë e ka pajisur murin e enës me një mjet që ul fërkimin në minimum për të siguruar një rrjedhje të butë dhe ena e gjakut të mbetet funksionale për shumë vite. Kjo realizohet nga një shtresë qelizash të sheshta që veshin enët e gjakut nga brenda dhe prodhojnë këto lëndë rrëshqitëse dhe një sërë lëndësh të tjera që më parë nuk njiheshin fare nga shkencëtarët. Ena e gjakut përveç shtresës së brendshme që quhet endotel ka edhe shtresën e muskulaturës së lëmuar e cila është përgjegjëse për qëndrueshmërinë dhe tonusin e enës. Sot njihet më mirë roli i endotelit i cili shkon përtej një barriere fizike sepse është zbuluar se qelizat e tij prodhojnë rreth 25 substanca që luajnë rol në koagulimin e gjakut, shumimin qelizor, përshkueshmërinë e kapilarëve dhe

sistemin imunitar. Sipërfaqja totale e endotelit në të gjithë organizmin është rreth 5000-6000 m², peshon rreth 2.5 kg dhe ka një gjatësi prej 96,000 km. Gjakut që vjen nga arteriet kalon deri në nivelin e kapilarëve dhe më pas në vena. Në kapilarë kryhet shkëmbimi i gazeve, lëngjeve dhe përbërësve ushqimor në mënyrë që indet të marrin furnizimet e nevojshme për të jetuar. Nga ana tjetër, produktet përfundimtare të metabolizmit kthehen në kapilarë për t'u filtruar nga veshkat dhe mushkëritë. Ky shkëmbim i lëndëve bëhet i mundur falë disa hapësirave të vogla që ndodhen në qelizat endoteliale të cilat realizojnë përshkueshmërinë e tyre. Në disa sëmundje si inflamacioni ose insuficienca kardiake rritja e presionit brenda kapilarëve bën që sasia e lëngjeve që del nga kapilari të jetë më e madhe se ajo që futet duke dhënë si rezultat ënjtjen në atë zonë (edemën). Inflamacioni nga ana tjetër nuk është diçka e dëmshme për organizmin, por një mekanizëm mbrojtës me të cilin Zoti e ka pajisur trupin tonë në rast dëmtimesh. Për shembull, inflamacioni që zhvillohet përreth vendit të pickimit të një blete është i dobishëm sepse pengon përhapjen e helmit në organizëm. Edhe në këtë rast qelizat e endotelit kanë funksione shumë të rëndësishme. Ato prodhojnë substanca që zgjerojnë kapilarët dhe hapësirat e vogla të tyre në mënyrë që lëndët të lëvizin lirisht nga njëra anë e kapilarit në tjetrën.

Ekulibrimi i presionit të gjakut

Shtresa e muskulaturës së lëmuar stimulohet nga substanca të çliruara nga qelizat endoteliale duke kontrolluar tkurrjen dhe lëshimin e enës së gjakut. Në këtë mënyrë rregullohet presioni i gjakut në enët falë këtyre qelizave. Gjatë një infeksioni bakteret të cilat qarkullojnë në gjak bëjnë që presioni i gjakut të bjerë ndjeshëm (shok septik). Substancat vazoaktive çlirohen me shumicë nga endoteli duke i lëshuar arteriet dhe venat në atë pikë që të kemi hipotension (tension i ulët) deri në shok hipovolemik. Nga ana tjetër në probleme si arterioskleroza, endoteli nuk e kryen siç duhet funksionin dhe mungesa e oksidit nitrik i bën ato të pandjeshme nga substancat vazoaktive gjë e cila çon në një tjetër situatë që është hipertensioni arterial (tensioni i lartë i gjakut).

Qelizat endoteliale parandalojnë hemorragjinë

Në rast hemorragjie, ena e gjakut duhet të ngushtohet për të minimizuar humbjen e gjakut. Ky veprim është shumë i rëndësishëm në çastet e para veçanërisht nëse ekziston një çrregullim i sistemit të koagulimit të gjakut. Kur ena e dëmtuar humbet gjak qelizat e endotelit fillojnë të prodhojnë një substancë që quhet endotelinë. Kjo bën të mundur ngushtimin e murit të enës duke tkurrur muskulaturën e lëmuar të saj. Endotelina nuk prodhohet në gjendje normale, por vetëm gjatë dëmtimit të enës. P.sh. kur pritret kordoni umbilikal i fëmijës së porsalindur kjo substancë parandalon rrjedhjen e gjakut nga trupi i fëmijës.

Qelizat endoteliale në koagulimin e gjakut

Detyra e qelizave endoteliale është të favorizojë ose të pengojë koagulimin e gjakut në varësi të situatës. Së pari, ato pengojnë ngjitjen e rruazave të gjakut me murin e enës duke parandaluar kështu mpiksjen e tij. Imagjinoni një tub në të cilin rrjedh ujë. Shpejtësia e rrjedhjes është më e madhe në qendër sesa në periferi të tubit duke bërë që kripërat të depozitohen në muret e brendshme në formë bigori. Edhe në enët e gjakut rrjedhja e tij është më e ngadaltë se në periferi por qelizat e gjakut nuk ngjisin me murin e enës. Kjo ndodh sepse Allahu i ka krijuar rruazat e gjakut dhe qelizat endoteliale të enës me ngarkesa negative të njëjta të cilat shtyhen me njëra tjetrën dhe falë një substance që quhet prostaciklinë e cila ndryshon formën e trombociteve që ato të mos ngjisin. Në rast të disa sëmundjeve që dëmtojnë endotelin në mënyrë kronike si diabeti, hipertensioni arterial ose duhanpirja mekanizmat mbrojtës nuk funksionojnë dhe mpiksja e gjakut në enë çon në trombozë. Në varësi të arteries së bllokuar nga tromboza, pasojat mund të jenë paraliza, infarkte dhe në jo pak raste vdekje. Nga ana tjetër, siç e përmendëm më lart janë po këto qeliza të endotelit që e favorizojnë mpiksjen e gjakut në rast dëmtimi të enës.

Qelizat endoteliale në palcën e kockave, mëlçi dhe shpretkë

Si një mirësi e Zotit të Gjithëmëshirshëm, qelizat endoteliale të këtyre organeve formojnë hapësira më të mëdha se në organet e tjera për arsye se këtu përveç shkëmbimit të gazeve dhe lëndëve ushqyese duhet të shkëmbehen edhe qelizat e gjakut, gjë e cila nuk ndodh në organet e tjera. Pra, rruazat e kuqe, të bardha dhe trombocitet e plakura largohen nga qarkullimi dhe i hapin rrugë rruazave të reja të futen në qarkullim, kështu që gjaku qëndron gjithmonë i freskët.

Qelizat endoteliale në tru dhe në sy

Qelizat endoteliale në organe si truri dhe syri janë të ngjitura fort me njëra tjetrën duke formuar një barrierë përzgjedhëse midis gjakut dhe qelizave të këtyre organeve. Elementët ushqyes si glukozja dhe oksigjeni kalojnë pa asnjë vështirësi, por substanca të tjera përfshirë edhe medikamentet nuk mund të kalojnë përmes kësaj barriere. Eksperimente të ndryshëm kanë vërtetuar se nëse një substancë e dëmshme futet në organizëm ajo mund të hyjë në të gjitha organet përveç trurit. Falë këtij mekanizmi mbrojtës, truri si organi më i ndjeshëm është i mbrojtur nga këto substanca të dëmshme. As edhe një qelize e vetme nuk është lënë në dorë të rastësisë, por duket se çdo gjë është vënë në vendin e duhur në harmoni të plotë me qëllimin dhe funksionin që duhet të kryejë në organizmin njerëzor.

Përktheu: Erion Sukaj

Boshllëku

Adoleshenti vuri re se u përplas me diçka të butë, teksa po ecte në errësirë. Në çast, u përkul të shikonte.

O Zot! Ç'të shihte! Në mes të këmbëve, kishte një zemër që ishte nxjerrë me mjeshtëri nga zgavra e saj. Ishte tamam si në fotografi, e gjallë dhe me gjak. Kur e mori në duar, i shastisur, sa s'u çmend nga tmerri.

Zemra rrihte dhe ishte e nxehtë.

Adoleshenti deshi të shpëtonte sa më parë nga ajo zemër, e cila iu ngjit në duar si të merrte situatën e një organi tjetër, por ai u pengua nga ca ndjenja që nuk po i kuptonte. Pas pak u qetësua dhe për të gjetur të zotin e kësaj zemre, trokiti në portën e shtëpisë më të afërt.

- A është e juaja kjo zemër? – pyeti vajzën e re që shikonte pas zinxhirit të derës. – E gjeta pak më parë në rrugë.

- Unë zemrën time ia dhashë një mosmirënjohësi që e njoha para tre muajsh, – u përgjigj vajza me një shprehje pafajësie. – Pyesni në shtëpinë pranë, mund të jetë e tyre.

Shtëpia që tregoi vajza ishte një vilë marramendëse. Shërbëtori që hapi derën, e mori djaloshin dhe e shoqëroi tek i zoti i shtëpisë në katin e sipërm.

- A është e juaja kjo zemër? – e pyeti djaloshi. – Ende rreh, prandaj...

Zotëria thithi një gllënjë nga gota e kristaltë dhe me

sytë që i ndrinin nga të pirët, tha duke u ngërdheshur:

- Unë zemrën time ia shita kësaj bote. Në shtëpinë bri jeton një mendjendritur, ai e di të zotin.

Adoleshenti vrapoi menjëherë për te kasollja aty pranë me zemrën në duar, e cila nisi të ftohej dhe të ngadalësonte të rrahurat.

- A është e juaja kjo zemër? – e pyeti. – Por shpejt ama, pothuaj po pushon së rrahuri.

I moshuari mbylli ngadalë Kur'anin që po lexonte.

- Unë zemrën time ia dhashë Allahut, së bashku me çdo gjë tjetër që kisha, – tha ai duke buzëqeshur. – Pronarin e asaj që ke në duar, pse nuk ua pyet nënës dhe babait tënd?!

- Që të dy janë plakur dhe lodhur, – tha duke shfryer djaloshi. – Ngaqë kërkojnë mbikëqyrje si një fëmijë, bëra shamatë me ta para tri ditësh dhe i braktisa.

- I braktise, ë? – tha burri plak i mërzitur. – Domethënë i braktise...

Adoleshenti dukej krejt i qetë nga kjo bisedë. Porse i moshuari e kishte marrë prej kohësh përgjigjen. Eci me hapa të sigurt drejt adoleshentit dhe e kapi me të dy duart nga këmbisha, duke e shqyer atë në çast.

Në gjoksin e adoleshentit kishte një boshllëk të gjakosur në madhësinë e zemrës që mbante në dorë.





Standarte bashkëkohore sipas rregullave qiellore!

PAMJE PANORAMIKE
USHQIM HALLAL
DHOMA ÇIFT, TRESHE & SUITA


BLUE ORCHIDEA
HOTEL

 Uji i Ftohtë, Vlorë

 www.blueorchidea.com

 069 565 3323